



Shqipëria mirëpret “Defender Europe 23”

Shqipëria mirëpret për herë të dytë “Defender 23”, dhe kjo si rezultat i arritjeve të suksesshme nga “Defender 21”.

“Defender 21”, stërvitja e përbashkët mbrojtëse shumëkombëshe e drejtuar nga Komanda në Evropë dhe ajo në Afrikë e ushtrisë së SHBA-së, arriti të ngrejë gatishmërinë dhe të realizojë ndërveprimin midis ushtrisë së SHBA-ve, NATO-s dhe ushtrive partnere, në mënyrë që bashkërisht të jemi të përgatitur

për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi. Shqipëria u zgjodh ndër shtetet e tjera për shkak të vendndodhjes së saj strategjike dhe faktit se ka qenë një partner i vlefshëm për SHBA-të prej vitesh. Kjo stërvitje u krye në pjesën e Ballkanit dhe Detit të Zi. Stërvitja ishte e natyrës mbrojtëse dhe u përqendrua në parandalimin e agresioneve, ndërsa përgatiti forcat tona për t’iu përgjigjur krizave nëse do ishte e nevojshme. Fokusi i “Defender

Europe 21” ishte krijimi i gatishmërisë operacionale dhe ndërveprimi me NATO-n dhe një numër më të madh të aleatëve dhe partnerëve në një zonë më të gjerë operacionesh. Kjo stërvitje ushtarake demonstroi aftësinë e SHBA-ve për të shërbyer si një partner strategjik sigurie në rajonet e Ballkanit Perëndimor dhe Detit të Zi. Këto stërvitje janë një shembull i shkëlqyer i aftësive tona... » faqe 2



Ministri Peleshi: Sllovenia, partnere dhe mbështetëse e Shqipërisë në rrugën e integrimit në Bashkimin European



SHSHPPFA, gjeneral brigade Kingji merr pjesë në Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s) e mbajtur në Sofje. Në këtë konference u diskutua mbi gjetjen e rrugëve të reja të bashkëpunimit ushtarak, ruajtjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rajonit. Në muajin nëntor, Shqipëria do të mirëpresë zhvillimin e stërvitjes së përbashkët “Strong Balkan-23”, si një mundësi e shkëlqyer që do të rrisë dhe forcojë ndërveprimin ushtarak...



» Faqe 2

Asllan Zemani: Kujtesa historike është palca e një kombi

Dr. Asllan Zemani, u lind në qytetin e Tiranës. Pas përfundimit të gjimnazit “Qemal Stafa”, vijoi studimet e larta në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1981 u titullua ‘oficer’. Më pas emërohet në detyrën e shefit të stërvitjes në brigadën sulmuese në qytetin e Librazhdit, e më pas shef i stërvitjes në repartin ushtarak të qytetit të Lezhës. Pas rreth tetë vjetësh në këto detyra, ndoqi studimet në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, pas të cilës emërohet komandant batalioni në njësitë e Tiranës. Boton shkrime...



» Faqe 8-9

Krijimi i bazës së Kuçovës, aseti i Forcave të Armatosura në rrugën e shndërrimit të saj në bazë të NATO-s

Reparti Ushtarak 3362 Kuçovë mbante emrin Reparti “23 Peza”. Ai u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej reparti. Krahës këtyre u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës. Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhiniero-teknik...



» Faqe 12

Shqipëria mirëpret “Defender Europe 23”


Shqipëria mirëpret për herë të dytë “Defender 23”, dhe kjo si rezultat i arritjeve të suksesshme nga “Defender 21”.

“Defender 21”, stërvitja e përbashkët mbrojtëse shumëkombëshe e drejtuar nga Komanda në Evropë dhe ajo në Afrikë e ushtrisë së SHBA-së, arriti të ngrejë gatishmërinë dhe të realizojë ndërveprimin midis ushtrisë së SHBA-ve, NATO-s dhe ushtrive partnere, në mënyrë që bashkërisht të jemi të përgatitur për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi.

Shqipëria u zgjodh ndër shtetet e tjera për shkak të vendndodhjes së saj strategjike dhe faktit se ka qenë një partner i vlefshëm për SHBA-të prej vitesh. Kjo stërvitje u krye në pjesën e Ballkanit dhe Detit të Zi. Stërvitja ishte e natyrës mbrojtëse dhe u përqendrua në parandalimin e agresioneve, ndërsa përgatiti forcat tona për t’iu përgjigjur krizave nëse do ishte e nevojshme. Fokusi i “Defender Europe 21” ishte krijimi i gatishmërisë operacionale dhe ndërveprimi me NATO-n dhe një numër më të madh të aleatëve dhe partnerëve në një zonë më të gjerë operacionesh.

Kjo stërvitje ushtarake demonstroi aftësinë e SHBA-ve për të shërbyer si një partner strategjik sigurie në rajonet e Ballkanit Perëndimor dhe Detit të Zi. Këto stërvitje janë një shembull i shkëlqyer i aftësive tona kolektive. Në të morën pjesë më shumë se 26 kombe dhe 28.000 trupa shumëkombëshe që kryen aktivitete pothuajse në të njëjtën kohë në më shumë se 30 zona trajnimi, të shtrira në 12 vende.

“Defender-Europe 21” përfshiu disa manovra dhe aktivitete ushtarake. Kryesoret janë: Përgjigja e Shpejtë, që ka të bëjë me operacione ajrore në Estoni, Bullgari dhe Rumani, ku u përfshinë më shumë se 7,000 trupa nga



11 vende; Përgjigja e menjëhershme, ku më shumë se 5.000 trupa nga 8 vende u shpërndanë në 31 zona trajnimi në 12 vende të ndryshme për të kryer trajnime dhe stërvitur për të hapur zjarr realisht; Mbrojtja kalorsiake, ku më shumë se 13.000 trupa kryen gjuajtje reale dhe operacione reale mbrojtëse me raketa si edhe një evakuim mjekësor në shkallë të gjerë; Stërvitja e Komandës post manovre, ku afërsisht një personel prej 2.000 vetash bënë manovra për aftësinë e shtabit për të komanduar forca tokësore shumëkombëshe në një mjedis të përbashkët dhe të kombinuar stërvitor, ndërkohë që kryen operacione në botën reale në 104 vende në dy kontinente.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve të “Defender-Europe 21” u zhvilluan në Ballkanin Perëndimor dhe zonat pranë Detit të Zi. Shqipëria ishte vendi kryesor mikpritës i kësaj stërvitjeje kaq gjigande ushtarake.

Rreth 5.000 forca amerikane u stërviten në Shqipëri, ato vepruan në vende të shumta në Shqipëri, përfshirë bazën ajrore në Kuçovë, në Farkë dhe në zonën e trajnimit në Bizë.

“Defender 2021” ishte një histori e jashtëzakonshme sfidash dhe suksesesh, jo vetëm për Forcat e Armatosura por për mbarë shtetin shqiptar. Përvoja dhe

angazhimi ynë i madh do të rikthehen në Shqipëri. Si stërvitje që shkojnë përtej dimensioneve ushtarake, tashmë kemi nisur përgatitjet për të pritur ‘Defender 2023’ dhe mijëra forcat tona aleate të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, - deklaroi ministri Peleshi në mbyllje të stërvitjes “Defender 21”, ku fill pas dy vitesh gjurmë suksesi, ministri i mbrojtjes Niko Peleshi do të informonte publikun e gjerë se:

“Për herë të dytë, Shqipëria do të mirëpresë stërvitjen më të madhe ushtarake në Evropë. Stërvitja nis me 22 maj. Shqipëria, si partner i besueshëm dhe si nyje strategjike e sigurisë rajonale, do të luajë një rol kyç në këtë stërvitje të rëndësishme ‘Defender Europe 23’ që është stërvitja më e madhe ushtarake që pret Shqipëria si aleate e NATO-s, me pjesëmarrjen e rreth 17 mijë trupave shumëkombëshe. Krenarë për këtë rol, duke treguar mbështetjen dhe angazhimin tonë maksimal për të gjithë ushtarakët dhe personelin që janë pjesë e këtij misioni të rëndësishëm”. Kjo stërvitje e përbashkët shumëkombëshe drejtohet nga Komanda Europiane e SHBA-ve, e cila do të demonstrojë aftësitë ndërvepruese të Shteteve të Bashkuara me ushtritë aleate dhe partnere të NATO-s.



SHSHPFA, gjeneral brigade Kingji merr pjesë në Konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s)

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në konferencën e Shefave të Shtabit të Përgjithshëm (BCHOD-s) e mbajtur në Sofje. Në këtë Konferencë u diskutua mbi gjetjen e rrugëve të reja të bashkëpunimit ushtarak, ruajtjen e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së rajonit.

Në muajin nëntor, Shqipëria do të mirëpresë zhvillimin e stërvitjes së përbashkët “Strong Balkan-23”, si një mundësi e shkëlqyer që do të rrisë dhe forcojë ndërveprimin ushtarak të vendeve pjesëmarrëse anëtare të nismës së BCHOD-s.



KLSM - 13 gjatë programit akademik pret si “Guest Speaker” ambasadorë rezidentë në Shqipëri

Në vijim të programi akademik, KLSM-13 ka pritur si lektor nderi Ambasadorin e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri z. Peter Zingraf. Ambasadori i shtetit Gjerman, zoti Zingraf prezantoi temën “Procesi i integritetit në Bashkimin European”, duke u ndaluar tek vlerësimi i përgjithshëm mbi integritimin e Shqipërisë në Bashkimin European dhe situatën gjeostrategjike të saj.

Më pas pjesëmarrësit në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, KLSM -13, kishin mundësinë të kishin si “Guest Speaker” ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri z. Alastair King-Smith, i cili prezantoi temën “Siguria rajonale, Europiane dhe Ndërkombëtare”, duke u ndaluar tek impakti i luftës në Ukrainë, reflektime dhe



vlerësime nga mësimet e nxjerra, qasja e Mbretërisë së Bashkuar ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor si dhe marrëdhënia e saj me Shqipërinë. Pjesëma-

rrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen gjatë prezantimeve treguan interes dhe adresuan pyetje mbi temat e prezantuara.



Ministri Peleshi: Sllovenia, partnere dhe mbështetëse e Shqipërisë në rrugën e integrimit në Bashkimin European

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vizitoi Slloveninë, me ftesë të ministrit të Mbrojtjes së Sllovenisë, Marjan Sarec. Në bisedën mes dy ministrave u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira dhe bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Sllovenisë, jo vetëm në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Ministri Peleshi theksoi se: “Sllovenia është një partnere e Shqipërisë dhe një mbështetëse e vendit tonë në rrugën e gjatë të integrimit në Bashkimin European”.

Në konferencën e përbashkët për mediat, z. Peleshi tha se e njohu homologun e tij ilarec mbi zhvillimet e fundit politike në Shqipëri, mbi reformat e realizuara si dhe angazhimin maksimal të qeverisë shqiptare drejt përmbushjes së objektivit madhor atë të anëtarësimit në Bashkimin European.

Duke vënë theksin tek roli i Shqipërisë në favor të fqinjësisë së mirë, prosperitetit dhe promovimit të vlerave demokratike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ministri Peleshi tha se kërkoi nga homologu slloven të vijonte mbështetjen në përfshirjen e Kosovës në nisma rajonale, në të cilat ajo mund të japë kontributin e saj dhe të jetë një vlerë e shtuar për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal.

Ministri i Mbrojtjes e njohu ministrin Sarec edhe me reformat dhe vëmendjen e veçantë të qeverisë shqiptare për reformimin dhe modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë këtu investime në fushën e Mbrojtjes kibernetike, në industrinë ushtarake si



dhe përmirësimin e ndjeshëm të trajtimit financiar të ushtarakëve. “Një vëmendje të veçantë po i kushtohet reformave në fushën e edukimit dhe trajnimit të

personelit të Forcave të Armatosura, për të cilat personalisht besoj fort se një investim i tillë sot do të sjellë një të ardhme më të ndritur dhe cilësore për

ushtarinë shqiptare”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Ministrat e Shqipërisë dhe Sllovenisë shkëmbyen ide dhe ranë dakord të intensifikojnë bashkëpunimin



në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes si dhe angazhuan stafet respektivë në hartimin dhe implementimin konkret të këtyre ideve.

Kursi i Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, vizitë akademike në Romë, Itali

Në vijim të programit mësimor, stafi drejtues dhe pjesëmarrësit e Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen, KLSM-13, zhvilluan vizita akademike në Romë, Itali.

Në vizitën e organizuar nga Qendra për Studimet e Larta të Mbrojtjes (CASD), pjesëmarrësit e kursit u pritën nga Drejtori i drejtorisë për Arsimin e Lartë dhe Edukimin Admiral Gaetano Virgilio, iu cili i uroi mirëseardhjen dhe i falënderoi për vizitën. Nëpërmjet prezantimeve nga përfaqësues të CASD, pjesëmarrësit e KLSM-13 patën rastin që të njihen me strukturën, misionin dhe kurrikulën mësimore të të gjitha kurseve institucionale që zhvillohen pranë kësaj qendre studimore, duke u ndalur tek kurset e niveleve kapiten - major - nënkolonel - kolonel dhe gjeneral, nëpërmjet Institutit të Studimeve të Larta të Mbrojtjes (IASD) dhe Kolegjit të Shërbimeve të Përbashkëta (ISSMI).

Në sesionin e pasdites, KLSM-13 vizitoi Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura italiane, ku u prit nga drejtori i Zyrës së Koordinimit Ndërkombëtar, kolonel Loreto Bolla, i cili, pasi i falënderoi për vizitën me anë të prezantimeve, i njohu pjesëmarrësit me misionin,



detyrat dhe rolin e ushtarisë Italiane në operacionet ushtarake të NATO-s dhe ato të Bashkimit European.

Në vijim të programit të vizitës, KLSM - 13 vizitoi Qendrën e

Ekselencës së NATO-s (NATO SFA COE), ku u prit nga drejtori, kolonel Massimo Di Pietro i shoqëruar nga shefi i Degës së Analizave dhe Mësimave të Nxjerra, major Jetnor Zogu.

Kolonel Di Pietro iu uroi mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe me një program të mirë organizuar i njohu personelin e kursit me të gjithë spektrin e veprimtarisë dhe bashkëpunimet e kësaj qen-

dre. Më pas, major Zogu prezantoi për pjesëmarrësit punën e bërë nga dega për mësimet e nxjerra dhe bashkëpunimet ndërkombëtare me Qendrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes Finlandeze (FINCENT) dhe Qendrën Ndërkombëtare të US për sigurinë ndërkombëtare. Pjesëmarrësit e KLSM-13 kishin mundësinë të vizitonin dhe Qendrën e Simulimit të veprimeve luftarake italiane, ku nënkolonel Marcello D'Agostino i njohu me të gjithë veprimtarinë e saj.

Pjesë e programit ishte dhe vizita në Institutin për Studime Globale (Insitute for Global Studies, IGS). Me një program të veçantë Profesor Nicola Pedde, drejtor i Institutit për Studimet Globale organizoi një seminar për çështjet e sigurisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku përveç KLSM-13, në seminar kishte ftuar dhe përfaqësues të Ambasadave të vendeve të Ballkanit në Romë, Atashe Ushtarake si dhe përfaqësues nga institucionet e sigurisë kombëtare të Italisë.

Në të gjitha vizitat akademike pjesëmarrësit e KLSM-13 treguan interes dhe vëmendje të veçantë, duke adresuar pyetje si dhe diskutuar mbi tema të caktuara.

Komandanti i Komandës Mbështetëse viziton repartet e varësisë

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo vizitoi efektivat e reparteve të varësisë.

Takimin e parë e zhvilloi në Bazën e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile (BMEC).

Ai u prit nga komandanti i këtij reparti, kolonel Hajdar Gurra, i cili i uroi komandantit suksese në detyrën e re dhe me një brifing të shkurtër e njohu me misionin, strukturën, kapacitetet dhe prioritetet e BMEC, për detyrat e saj në përballimin e situatave të EC, si në përmbyetje, shuarjen e zjarreve e fatkeqësive natyrore. Gjithashtu komandanti i KM-së pa nga afër punimet e kryera për rristrukturimin e infrastrukturës së repartit.

Më tej vizita e tij vijoi në batalionin e Xhenios, ku u prit nga komandanti i këtij reparti kolonel Shkëlzen Mhillaj.

Nëpërmjet një brifingu të shkurtër Komandanti i KM-së u njoh me Misionin, strukturën kapacitetet dhe prioritet që ka në ndihmë të komunitetit dhe FA-së, detyrat specifike të EOD-së, ndërtimin e urave, detyra në



mbështetje të strukturave të FA-së për zhvillimin e infrastrukturës. Kërkimi, zbulimi, çminimi dhe asgjësimi i municioneve të rrezikshme dhe lëndëve plasëse brenda dhe jashtë vendit si dhe kryerjen e operacioneve të EC.

Në të dy repartet gjeneral bri-

gade Dimo falënderoi efektivin për përkushtimin në punë, për shpirtin e sakrificës në realizimin e çdo detyre në kohë dhe u premtoi atyre se do të kenë nga ai mbështetjen e pakursyer për të përmbushur detyrat dhe realizimin e misionit të tyre kushtetues.



Gjeneral brigade Ferdinand Dimo pret atasheun ushtarak turk, kolonel Kablay

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo priti në një takim kortezie atasheun ushtarak turk, kolonel Muhammet Kelami Kablay.

Gjeneral brigade Dimo, pasi i uroi mirëseardhjen, shprehu mirënjohje dhe falënderim për ndihmën dhe asistencën e dhënë nga qeveria turke në drejtim të arsimimit, trajnimit dhe mbështetjes logjistike me teknikë e pajisje të Forcave tona të Armatosura si dhe në veçanti të Komandës Mbështetëse, në drejtim të kompletimit të kompanisë EOD dhe asaj të Kërkim - Shpëtimit me pajisje moderne.

Nga ana e tij, kolonel Kablay, duke i uruar komandantit të Komandës Mbështetëse suksese në detyrën e tij të re, shprehu bindjen se bashkëpunimi i nisur midis dy ushtrive tona do të vijojë më tej me modernizimin e FA-së dhe të rinovimit të teknikës së Batalionit të Transportit në Komandën Mbështetëse, e siguroi atë se qeveria turke do të vazhdojë të kontribuojë në drejtim të modernizimit të FARSH-së me sisteme, pajisje e teknikë logjistike, si dhe arsimimin e të rinjve në fushën e mjekësisë dhe atë ushtarake.

Në përfundim të takimit, të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve edhe në të ardhmen.



Nën drejtimin e instruktorëve të saj më të mirë, prej disa ditësh në repartin ushtarak nr. 1010 Vau i Dejës, Shkodër dhe repartin ushtarak nr. 1030 Poshnje, Berat ka filluar Stërvitja Individuale Bazë (SIB) dhe Stërvitja Individuale e Avancuar (SIA). Synimi i këtyre kurseve, është transformimi i rekrutëve të rinj nga civilë, në qytetarë të denjë nën uniformë për t'i shërbyer atdheut në çdo kohë dhe në çdo vend.



Në Camp Villaggio Italia u zhvillua stërvitja MASCAL, ku dy Kontingjentet KFOR 3 dhe KFOR 1 treguan profesionalizëm të lartë në realizimin e detyrave të ngarkuara nga Zëvendës Komandanti i RC-W, nënkolonel Pëllumb Hidri në cilësinë e drejtuesit të stërvitjes. Nënkolonel Hidri vlerësoi maksimalisht trupat për përkushtimin dhe disiplinën e treguar gjatë ekzekutimit të stërvitjes.



Distria Krasniqi, xhudistja më e mirë në botë për kategorinë deri në 52 kilogramë

Xhudistja Distria Krasniqi, pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me gradën honorifike 'kolonel' është renditur e para në botë. Sipas Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, ajo ka marrë 7275 pikë në kategorinë deri në 52 kilogramë. Pas saj, në renditje është xhudistja britanike, Chelsie Giles, e cila ka marrë 7010 pikë. E treta është shpallur japonezja, Uta Abe, e cila arriti të grumbullonte 6800 pikë. Krasniqi gjithashtu na bëri krenarë të gjithëve pasi fitoi medaljen e artë në Lojërat Olimpike "Tokyo 2020".

Disa muaj më parë, ajo ka fituar edhe një tjetër medalje të artë në "Grand Slam" në Paris, pasi mposhti xhudisten Reka Pupp. Tani, Distria po bëhet gati për "Lojërat Olimpike 2024", ku jemi të sigurt se do të triumfojë.

Po kush është Distria Krasniqi, shqipja që po na bën krenarë me arritjet e saj në të gjithë botën?

Distria Krasniqi erdhi në jetë më 10 dhjetor 1995, është një xhudiste kosovare, e cila garon kryesisht në kategorinë deri në 52 kg. Medaliste në kampionatin botëror dhe kampionatin evropian në konkurrencën e juniorëve. Pjesëmarrëse në Lojërat Evropiane në vitin 2015.

Filloi sportin e xhudos në moshën 7-vjeçare me këmbënguljen e vëllait të saj. Fillimisht ka luajtur në arenën ndërkombëtare nën flamurin e Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, duke mos qenë në gjendje të luante për Kosovën. Në atë kohë ka fituar një numër të konsiderueshëm medaljesh në ngjarjet sportive të nivelit ndërkombëtar, si p.sh. në Kampionatin European (nën 23 vjeç) në vitin 2012 ku zuri vendin e 3-të, dhe në vitin 2013, fitoi një medalje bronz në



Kampionatin European në kategorinë e juniorëve (nën 21). Në vitin 2015, Distria Krasniqi fillon pjesëmarrjen në garat ndërkombëtare si përfaqësuese e Kosovës. Duke mbrojtur ngjyrat e vendit të saj në vitin 2015, fitoi një medalje bronz në Kampionatin European në kategorinë e juniorëve, dhe gjithashtu u bë Kampione Botërore (vajza nën 21).

Mori pjesë në Garat Evropiane në vitin 2015, ku, pas disfatës prej italiane Odetta Giuffrida, kaloi në 1/8 e finales. Ajo ka fituar 6 medalje në kualifikimet olimpike. Fitoi gjithashtu medaljen e bronzit në 'Grand Slam' në Paris në vitin 2017 dhe po ashtu medaljen e bronzit në 'Open European' në Sofje, në vitin 2017.

Në vitin 2021, ajo fitoi medaljen e artë në veprimtarinë e saj në Mjeshtrit Botërorë të Xhudos 2021, të mbajtur në Doha, Katar.



Fusha kibernetike dhe hapësinore: Ndikimi në zhvillimin e operacioneve të mbrojtjes



N/KOL. (R) MSC. KANAN HIMAJ

Sot, diskutimi për sfidat e mbrojtjes kibernetike dhe ngritjen e kapaciteteve në FA trajtohen si çështjet më të ndjeshme nga ekspertët të fushave të tyre përkatëse, dhe jo vetëm.

Objekti i konferencës është për të ofruar mbështetje të mëtejshme për ndërtimin e kapaciteteve për të luftuar kërcënimet kibernetike. Pra janë momente për të gjithë ne, të trajtojmë tendencat e politikave të mbrojtjes kibernetike, duke përfshirë forcimin e qëndrueshmërisë kombëtare kibernetike në hapësirën kibernetike.

Kërcënimet kibernetike janë bërë një tipar i vazhdueshëm i jetës sonë të përditshme dhe ekosistemit në të cilin jetojmë. Kohët e fundit, hapësira kibernetike është keqpërdorur gjithnjë e më shumë nga aktorë të ndryshëm për të krijuar çrregullime, për të prishur funksionimin e shërbimeve të ndryshme publike, infrastrukturave kritike dhe për rrjedhojë uljen e cilësisë së jetës sonë. Sulmet kibernetike dhe aktivitetet keqdashëse kibernetike ndodhin vazhdimisht në kohë paqeje, krize dhe konflikti me efekte shkatërruese.

Njohja e dy mjedisëve/fushave të reja operationale, mjedisit kibernetik dhe mjedisit hapësinor, ka çuar në përfytyrimin e disa mundësive ‘asimetrike’ të përfshirjes së një kundërshtari, me qëllim krijimin e dilemave të shumta për të, të cilat ai duhet t’i marrë në konsideratë. Kjo qasje ndaj operacioneve ushtarake është aktualisht e lidhur me konceptin e ri të operacioneve me shumë fusha. Megjithatë, duhet theksuar se jo vetëm njohja e dy mjedisëve të reja, por edhe mjedisi i ardhshëm i funksionimit në tërësi është një faktor nxitës. Kështu, në këtë artikull, qëllimi është të identifikojmë shkallën në të cilën dy mjediset e reja operationale kontribuojnë në zhvillimin e konceptit të ri të operacioneve, me qëllim që të nënvizojë rrugët e mundshme përpara në drejtim të zbatimit të operacionit, konceptin dhe zhvillimin e veprimeve specifike nga mjediset kibernetike dhe hapësinore. Pas vlerësimeve dhe analizave të kryera, janë venë re se fushat kibernetike dhe hapësinore po humbasin gradualisht rëndësinë brenda fazave të operacionit, ndërkohë që veprimet po copëzohen dhe decentralizohen. Ky fakt duhet të merret parasysh në zhvillimin e formacioneve.

Megjithëse fusha kibernetike dhe ajo hapësinore shihen përgjithësisht si mjedisë që përmirësojnë ose mbështesin veprimet në ajër, tokë dhe në det, unë besoj se, në mjedisin aktual të sigurisë, rëndësia e tyre nuk është më pak e rëndësishme se ajo e fushave konvencionale. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se ato mund të ndikojnë në fuqinë luftarake të një kundërshtari të mundshëm ose të forcave të tyre në një masë të tillë që përqindja e forcave të



prekura prej tyre mund të jetë vendimtare në rezultatit e një konflikti, edhe para se konflikti të arrijë në fushëbetejën e saj të konfliktit të hapur.

Besoj se kjo është në fakt tipologjia e llojit të ri të konfliktit, në kuptimin e arritjes së objektivave me mjete që nuk e kalojnë kufirin që konsiderohet si shkas për planifikimin dhe zhvillimin e veprimeve ushtarake konvencionale, si p.sh. fillimi i një lufte konvencionale. Kështu, dy fushat e reja duket se i përshtaten në një masë të madhe asaj që qarkullon në mjedisin e tanishëm dhe të ardhshëm të sigurisë. Kjo është edhe arsyeja që mendoj se analiza e zhvillimeve në mjediset kibernetike dhe hapësinore është e rëndësishme në ditët e sotme.

Megjithatë, duhet të pranojmë që në fillim se këto mjedisë ndikojnë, në idenë e deklaruar më parë për përmbushjen e objektivave pa shkaktuar një konflikt të hapur, në një masë më të madhe të instrumenteve të fuqisë së shtetit, përveç atyre ushtarake, si ato diplomatike, informative dhe ekonomike. Instrumenti ushtarak ndikohet në një masë më të madhe vetëm gjatë harkut kohor në të cilin shkaktohet konflikti i hapur.

Në vërejmë një mungesë lineariteti, në kuptimin që dy fusha të bashkangjitura me ato klasike dhe në varësi të instrumentit ushtarak kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në instrumentet diplomatike, informative dhe ekonomike, duke i shërbyer më pak instrumentit ushtarak në operacionet me shumë drejtime si faza e konkurrencës. Ky kompleksitet mund të jetë i vështirë për t’u menaxhuar. Megjithatë, është e nevojshme të analizohen elementët që dy mjediset e reja futin në marrëdhëniet e tyre me mjediset klasike dhe brenda instrumentit ushtarak në tërësi. Kjo mund të çojë në një ndërgjegjësim për mundësitë e përdorimit inovativ të forcave të armatosura në operacionet ushtarake.

Duke u nisur nga premisa se fusha kibernetike dhe ajo hapësinore synojnë, brenda veprimeve ushtarake, të rrisin dhe mbështesin veprime nga mjedisë të tjera (ato mund të kategorizohen si shumëfishues të forcës), ne mendojmë dhe synojmë në verifikimin e hipotezës së mëposhtme kërkimore: fushat kibernetike dhe hapësinore do të çojnë në zbritjen e taktikave të reja për shërbimet që operojnë në mjedisë klasike (përfshirë kombinimin e tyre inovativ sipas nivelit

operacional) dhe do të ndikojë në mënyrën e arritjes së objektivave strategjike ushtarake. Për të nxjerrë përfundime pragmatike që konfirmojnë ose hedhin poshtë hipotezën e krijuar kërkimore, ne do të nënvizojmë korrelacionet e vendosura midis dy fushave të reja dhe operacioneve me shumë drejtime dhe qëllime në tërësi, duke marrë parasysh të dhënat që supozohet të përdoren në këtë punë, zakonisht ka me vete njësi që kanë misionet të tilla si intelijenca përmes veprimeve kibernetike – brenda veprimeve të interpretimit/përpunimit të informacionit.

Shembuj në mbështetje të kategorive të identifikuar janë lartpërmendur, por shkalla në të cilën këto kategori mund të përdoren në ushtri më të vogla është e vështirë për t’u llogaritur. Kështu, besoj se në lidhje me zhvillimet në fushën kibernetike, mund të thuhet se mbrojtja, manipulimi, evazioni dhe përdorimi i informacionit, aspekte që përmbledhin kategoritë e paraqitura, paraqesin një sofistikim të misionit bazë të identifikuar.

Si rezultat, megjithëse ky përpunim i misionit kryesor nuk është pa bazë, duke qenë se zhvillimet teknologjike kanë ofruar një gamë gjithnjë e më të gjerë për identifikimin dhe përdorimin inovativ të mjeteve që mund të ofrojnë ky mjedis, besoj se është e rëndësishme të kujtojmë se është vetë informacioni që drejton zhvillimet në këtë mjedis.

NATO i ka përkufizuar si ‘mjedisi i pestë’, në dhjetor 2019, ndërsa në takimi i liderëve të vendeve anëtare të NATO-s (NATO 2022), ka njohur atë si një çështje që lidhet me sigurinë e Aleancës. Kërcënimet kryesore që NATO ka identifikuar në këtë mjedis, ato që lidhen me efektet fizike në hapësirën e jashtme dhe veprimet e drejtuara ndaj aftësive në hapësirë.

Megjithatë, mendoj se është shumë më e rëndësishme të theksohet, nga pikëpamja ushtarake, fakti se nga ky domen mund të ndikohen veprimet në të gjitha fushat e tjera, kështu që hapësira shihet më shumë si një faktor potent për veprimet në fushat e tjera, pa të cilat veprimet e forcave të armatosura mund të privohen nga avantazhi i informacionit të plotë për një kundërshtar të mundshëm. Në këtë kuptim, shqetësimet kryesore përfaqësohen nga: fakti që përfaqëson një mjedis integruar për komunikim;

mundëson mbledhjen, interpretimin e informacionit në mbështetje të operacioneve dhe misionëve; me ndihmën e satelitëve, krizat mund të monitorohen dhe NATO dhe mund të ndërhyjë në mënyrë efektive në kohën e duhur.

Pra, konsideroj se veprimet në fushën hapësinore mund të ndahen në veprime fizike që zhvillohen në hapësirë në mjete hapësinore dhe veprime që janë të drejtuara drejt katër fushave të tjera. Këto të fundit ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e ushtrisë. Megjithatë, është evidente se zhvillimi i aftësive për të shkatërruar satelitët e lëshuar në këtë mjedis parashikohet për të parandaluar kategorinë e dytë të misionëve në këtë mjedis. NATO i ndan veprimet hapësinore në veprime drejt, nga dhe në hapësirë. “NATO ka pranuar se sulmet në, nga ose në hapësirë paraqesin një sfidë të qartë për sigurinë e Aleancës dhe mund të çojnë në thirrjen e nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut” (NATO 2022).

Kështu, bazuar në elementët përcaktues të operacioneve me shumë fusha të paraqitura në dokumentin e lartpërmendur, koncepti mund të ndahet në tre elementë kryesorë që kontribuojnë në kuptimin e konceptit të ri: menaxhimi i informacionit (sidomos në fazën e parë dhe të pestë – konkurrim dhe rikthim në konkurrencë në kushte të favorshme) – veprime që nuk varen vetëm nga instrumenti ushtarak; adresimi i çështjes A2/AD (fazat e dyta dhe të treta – depërtimi dhe shpërbërja) dhe kryerja e operacioneve të përbashkëta të përshtatura me kushtet e reja në mjedisin operacional, nëpërmjet mbështetjes ndërmjet shërbimeve (shfrytëzimi).

Duke qenë se në dy pjesët e para u prezantuan elementët që lidhen me dy fushat e reja si dhe përshkrimi përmbledhës i operacioneve me shumë fusha, do të paraqes shkurtimisht disa aspekte që lidhen me thellësinë strategjike, duke pasur parasysh faktin se, kryesisht, qëllimi i një operacioni, në rastin tonë është të kontribuojë në arritjen e objektivave të nivelit strategjik. Megjithatë, duhet theksuar se operacionet me shumë fusha ka shumë të ngjarë të kryhen në një nivel strategjik për shkak të shtrirjes dhe diversitetit të veprimeve të përfshira (duke mos qenë tërësisht nën komandën dhe kontrollin e instrumentit ushtarak.

Problemi me të cilin përballemi, në

mjedisin aktual të sigurisë, është fakti se thellësia strategjike nuk i referohet më vetëm hapësirës fizike (gjeografike) dhe mund të ketë forma të ndryshme që janë shfaqur si rezultat i mënyrave të menaxhimit të informacionit dhe rritjes së saktësisë dhe goditjes së sistemeve të armëve. Kjo është arsyeja që nevojitet një lloj i ri operacioni për t’iu përgjigjur zhvillimeve të reja të konceptit të thellësisë strategjike, në kuptimin e një ideje të re që përmbledh realitetin aktual dhe atë që pritet të ndodhë në të ardhmen e afërt.

Prandaj besoj se ajo do të jetë objekt diskutimi pasi çështja duhet të shqetësojë ushtarakët që janë përgjegjës për zhvillimin e këtij koncepti, identifikimi i mënyrave të përdorimit të fushave kibernetike dhe hapësinore brenda veprimeve specifike për shërbimet ose nxjerrja e taktikave të reja nga shërbimet që marrin parasysh mundësitë e përdorimit të teknologjive nga dy mjediset e reja.

Duke ndihmuar procesin e parapërgatitjes për diskutime të gjera, shkrimi ka subjekt sidomos ndikimin e dy mjedisëve të reja operationale në zhvillimin e një koncepti të ri të quajtur operacioni me shumë fusha që synon të sintetizojë realitetin përmes një ideje, përshkrimi i elementëve që përbëjnë dy mjediset se menaxhimi inovativ i informacionit i mundësuar nga teknologjia përfaqëson një përditësim të instrumentit ushtarak, duke i mundësuar të ndikojë në rezultatit e një konflikti që në fazat e hershme.

Kontrolli i hapësirës ajrore është thelbësor për kryerjen e veprimeve ushtarake në mjediset detare dhe tokësore, kontrolli i mjedisëve kibernetike dhe hapësinore është gjithashtu vendimtar për operacionet me shumë fusha, pasi të gjitha këto veprime përfaqësojnë një operacion me shumë fusha.

Brenda këtij kuadri në mënyrë empirike trajtova konceptin e thellësisë strategjike, i cili për mendimin tim është objektivi i nivelit strategjik që operacioni me shumë fusha duhet të jetë në gjendje të arrijë, duke marrë parasysh faktin se thellësia strategjike e epokës së informacionit ndryshon nga ajo që përfaqëson në Luftën e Dytë Botërore.

Në vijim theksoj se çështje të tilla janë edhe doktrinat për faktin se fushat kibernetike, duke analizuar korrelacionet midis tre elementëve, arrijmë në përfundimin se, për instrumentin ushtarak, faza e shfrytëzimit të operacionit me shumë fusha është faktori kyç i suksesit të tij. Gjithashtu, çështjen e zbatimit të elementeve nga mjedisi kibernetik dhe ai hapësinor brenda shërbimeve, ato duhet të jenë në gjendje të mbështesin operacionet e përbashkëta (faza e shfrytëzimit). Ky aspekt për ne duhet të jetë objekt për zhvillimin e këtij koncepti dhe duhet të çojë në përsosjen e taktikave të shërbimeve për të përfshirë elementët që ofrojnë dy mjediset e reja.

Në përfundim, unë konsideroj se fushat kibernetike dhe hapësinore nuk e kanë arritur ende potencialin e tyre maksimal brenda operacioneve me shumë fusha, dhe shkalla në të cilën ata do të arrijnë këtë potencial përcaktohet nga mundësia e një konflikti midis fuqive të mëdha ushtarake që janë të gatshme për të investuar në zbatueshmërinë ushtarake të teknologjive të reja specifike për këto dy fusha.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S NË SAMITIN E DEMOKRACISË NË KOPENHAGË

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, mori pjesë virtualisht në Samitin e Demokracisë në Kopenhagë, më 15 maj 2023, në një bisedë me ish-Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, themelues dhe kryetar i Fondacionit Aleanca e Demokracive. Ata diskutuan përgatitjet për Samitin e NATO-s në korrik, përfshirë mbështetjen e NATO-s për Ukrainën, rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes dhe angazhimin me partnerët në rajonin Indo-Paqësor.

Stoltenberg tha se kishte besim se liderët e NATO-s do t'i dërgonin një mesazh të qartë mbështetjeje Ukrainës në Samitin në Vilnius. Ai tha se: “Unë pres që ne do të biem dakord për një program shumëvjeçar, ku do të punojmë se si të ndihmojmë Ukrainën të kalojë nga standardet, doktrinat dhe pajisjet e kohës sovjetike në standardet dhe doktrinat dhe pajisjet e NATO-s dhe të bëhet plotësisht e ndërveprueshme me NATO-n”. Ai shtoi se: “Ndërsa ne nuk e dimë se si do të përfundojë lufta e agresionit të Rusisë, ajo që dimë është se kur të përfundojë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ne të jemi në gjendje të parandalojmë që historia të përsëritet”.

Sekretari i Përgjithshëm tha gjithashtu se ai priste një vendim ambicioz për investimet në mbrojtje në Samitin e Vilniusit, me 2% të prodhimit të brendshëm bruto si dysheme, jo tavan. Ai përmendi se kishte ftuar në Samit liderët e partnerëve të NATO-s në rajonin Indo-Paqësor, Australinë, Japoninë, Zelandën e Re dhe Republikën e Koresë, sepse sfidat me të cilat përballemi janë globale.

Samiti i NATO-s në Vilnius, shprehje e forcës, vendosmërisë dhe unitetit

Bashkëbisedimi mes Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg dhe themeluesit dhe Kryetarit të Fondacionit Aleanca e Demokracive, Anders Fogh Rasmussen në Samitin e Demokracisë në Kopenhagë filloi me trajtimin në të gjerë të ngjarjes të korrikut të këtij viti, kur NATO do të mbajë Samitin në Vilnius. Pritet që Samiti në Vilnius të shprehë më së miri forcën, vendosmërinë dhe unitetin përpara Samitit jubilar që do të mbahet në Uashington vitin e ardhshëm.

“Samiti në Vilnius do të jetë një samit shumë i rëndësishëm sepse takohemi në një moment kritik për sigurinë tonë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Stoltenberg. “Samiti do të demonstrojë edhe një herë se NATO është aleanca më e fortë dhe më e suksesshme në histori për shkak të dy gjërave, që janë për shkak të aftësisë sonë për t'u përshtatur me ndryshimet kur bota po ndryshon dhe kur përballemi me kërcënimin dhe sfida të reja, dhe e dyta aftësia jonë për të qëndruar së bashku, uniteti ynë. Por para së gjithash, samiti do të duhet ta demonstrojë këtë në mënyrën se si aleatët të rritet mbështetjen e NATO-s për Ukrainën. “Unë pres që aleatët të përsërisin dhe më pas të forcojnë dhe mbështesin mbështetjen për Ukrainën, mbështetjen politike, praktike dhe ushtarake. Por gjithashtu ne do të biem dakord për plane të reja se si të forcojmë më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë. Sepse në thelb, detyra e NATO-s është të mbështetë Ukrainën, siç kanë e kanë bërë tashmë aleatët e NATO-s dhe NATO prej më shumë se një viti, por edhe të parandalojë që kjo luftë të përshkallëzohet përtej Ukrainës. Për këtë arsye, mezi pres që aleatët të bien dakord për planet e reja dhe angazhimet e reja për të forcuar mbrojtjen tonë kolektive dhe praninë tonë në pjesën lindore të Aleancës”. Stoltenberg tha se në Samitin e korrikut, NATO do të angazhohet



gjithashtu me partnerët në Azi-Paqësor. “Për herë të dytë në historinë tonë, ne do të ftojme të marrin pjesë krerët e shteteve dhe qeverive nga Japonia, Koreja e Jugut, Zelande e Re dhe Australia, kjo tregon se ne e kuptojmë se ajo që ndodh në Azi, në Paqësor, ka rëndësi për NATO-n, dhe për këtë arsye ne po forcojmë partneritetin tonë me ta”.

Çështja e anëtarësimit të Ukrainës në NATO, në fokus të samitit

Bashkëbisedimi midis Rasmussen dhe Stoltenberg u fokusua gjithashtu edhe mbi çështjen e anëtarësimit të ardhshëm të Ukrainës në NATO, e cila është një çështje që do të diskutohet në Samit. Sekretari i Përgjithshëm tha se aleatët e NATO-s, krerët e shteteve dhe qeverive, kur të takohen në korrik, do të dërgojnë një mesazh shumë të qartë mbështetjeje për Ukrainën dhe kjo do të manifestohet në mënyra të ndryshme. Stoltenberg tha se kur bëhet fjalë për anëtarësimin, ai pret që aleatët e NATO-s, do të thonë se Ukraina do të bëhet anëtare e Aleancës, dhe kjo është deklaruar disa herë nga krerët e shteteve dhe qeverive, gjithashtu të gjithë aleatët pajtohen se Ukraina ka të drejtë të zgjedhë rrugën e saj. “Nuk i takon Moskës të vendosë se çfarë mund të bëjë Ukraina, është për Ukrainën dhe 31 aleatët e NATO-s të vendosin për çështjen e anëtarësimit. Dera e NATO-s mbetet e hapur”, - tha shefi i NATO-s. Por ai tha se pret që aleatët të bien dakord për një program shumëvjeçar për Ukrainën, ku do të punohet se si të ndihmohet Ukraina të kalojë nga standardet, doktrinat, pajisjet e kohës sovjetike në standardet, doktrinat dhe pajisjet e NATO-s dhe të bëhet plotësisht e ndërveprueshme me NATO-n. Që nga ana tjetër për ta bërë këtë, kjo është ajo që i ndihmon atë të ecë drejt anëtarësimit në NATO. Stoltenberg tha se beson fuqishëm se të gjithë aleatët do të deklarojnë se detyra më urgjente tani është të sigurohet që Ukraina të mbizotërojë, që Presidenti Putin të mos fitojë në këtë luftë. Sepse vetëm nëse Ukraina mbizotëron si një komb sovran i pavarur në Evropë, atëherë ka kuptim diskutimi se kur dhe si Ukraina mund të bëhet anëtare e Aleancës”.

Ish-Sekretari i Përgjithshëm Rasmussen nga ana e tij tha se do të duhet pak kohë për të kuptuar se në cilat kushte Ukraina mund të anëtarësohet përfundimisht në NATO, por në të njëjtë kohë deri në anëtarësim, ajo ka nevojë

për garanci sigurie. “Pra derisa Ukraina të mund të bashkohet me NATO-n do të duhet që aleatet të mund të bien dakord për një grup garancish sigurie për të”. Sekretari i Përgjithshëm tha se lidhur me këtë ka konsultime që po zhvillohen, si gjithmonë përpara Samitit, midis aleatëve në NATO (në Bruksel) dhe në kryeqytetet e Aleancës. Ai tha se është shumë herët për përfundimet e sakta të takimit të krerëve të shteteve dhe qeverive, por ka konsultime të vazhdueshme. “Por ajo çfarë është e rëndësishme, - nënvizoi ai, - është se të gjithë aleatët e kuptojnë se ne duhet të ofrojmë mbështetje ushtarake për Ukrainën. Ndërkohë më shumë se 150 miliardë euro janë dhënë tashmë në mbështetje ushtarake, dhe këtë fundjavë u njoftua se Gjermania do të ofrojë më shumë se 2 miliardë euro, gjithashtu edhe SHBA. Pra, aleatët po ofrojnë mbështetje ushtarake dhe kjo është e rëndësishme që Ukraina të mbizotërojë, të fitojë luftën, por gjithashtu të forcojë Ukrainën pas luftës, të jetë në gjendje të pengojë dhe mbrojë çdo agresion të mëtejshëm. Ne nuk e dimë se si do të përfundojë kjo luftë, por ajo që dimë është se kur të përfundojë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ne të jemi në gjendje të parandalojmë që historia të përsëritet. Do të thotë se ne duhet të sigurojmë që modeli që kemi parë, modeli i agresionit rus kundër fqinjëve, në Gjeorgji në 2008, Krime 2014 dhe më vonë në lëvizjen e Rusisë në Donbasin lindor dhe më pas pushtimin e plotë vitin e kaluar, duhet të ndalet.”

“E vetmja mënyrë për të siguruar që kjo të funksionojë është pjesërisht të sigurohet që Ukraina të ketë forcën ushtarake për të penguar dhe mbrojtur kundër agresionit të mëtejshëm nga Rusia, por gjithashtu për të gjetur një lloj kuadri për të parandaluar Rusinë, ose Presidentin Putin, që të vazhdojnë të largohen nga siguria evropiane. Saktësisht çfarë lloj kuadri, nuk mund t'ju them tani, por ajo që mund të them është se nëse aleatët e NATO-s dhe veçanërisht dhe natyrisht të mëdhenjtë, të fillojnë të lëshojnë garanci sigurie dypalëshe për Ukrainën, ne jemi shumë afër nenit 5. Pra, atje nuk është një mënyrë për të gjetur një zgjidhje të lehtë për këto çështje. Gjëja më e rëndësishme është të jemi shumë të fortë në mbështetjen tonë për Ukrainën, në mënyrë që Ukraina të mbizotërojë si një komb sovran i fortë dhe i pavarur në Evropë”.

Angazhimi i aleatëve për të investuar mjaftueshëm në mbrojtje

Në Samitin e NATO-s në Uells në vitin 2014, aleatët vendosën që brenda dekadës së ardhshme, të gjithë do të vinin në zbatim angazhimin për të investuar të paktën 2% të PBB-së në mbrojtje. Por Raporti i fundit Vjetor i Sekretarit të Përgjithshëm tregoi se vetëm shtatë aleatë e arritën objektivin prej 2% në vitin 2022. “Kjo është një nga çështjet që do të trajtohet gjithashtu në Vinus, - tha Rasmussen, - por si do t'i shtynit aleatët që në fakt të përmbushin angazhimet e tyre që nga viti 2014?”, - pyeti ai Sekretarin e Përgjithshëm gjatë bisedës.

Stoltenberg tha se edhe pse vendimi në Uells në 2014 nuk ishte i lehtë për t'u arritur, ai shërbeu si pikënisje. “Kjo reflektoi se disa aleatë ishin shumë të etur për të lëvizur shpejt në 2% e më tej, dhe aleatë të tjerë ishin shumë ngurrues. Pra, nëse është mirë apo keq, ku jemi tani, varet pak nga fakti nëse e vlerësoni gotën gjysmë të mbushur apo gjysmë bosh”, - specifikoi shefi i NATO-s. “Realiteti është se që nga viti 2014, ne kemi bërë një rrugë të gjatë për shpenzimet e mbrojtjes, edhe pse do të kisha vlerësuar shumë që aleatët e NATO-s të kishin bërë edhe më shumë”.

Ajo që vërehet është se para vitit 2014, aleatët në të gjithë Evropën dhe në Kanada po reduktonin shpenzimet e mbrojtjes, ndërsa që nga viti 2014, të gjithë aleatët kanë rritur shpenzimet e mbrojtjes, disa më shumë se të tjerë, por të gjithë kanë shkuar nga zbritja në rritje, gjë që është një ndryshim i madh. “Ne kemi më shumë se dyfishuar numrin e aleatëve që përmbushin objektivin prej 2%, dhe madje edhe ata që nuk janë ende në 2% kanë tani plane për të qenë atje brenda disa viteve. Për shembull, Gjermania, ata nuk janë aty me 2%, por rritja që ata kanë filluar të ofrojnë tashmë bën një ndryshim të madh për shkak të madhësisë së Gjermanisë dhe për shkak të sasisë 100 miliardë euro, që është lënë mënjanë që u mundëson atyre të arrijnë 2% së shpejti .

Por gjithashtu mbi sfidën e 2% për mbrojtjen në Samitin e Uellsit kishte pikëpamje të ndryshme nga aleatët kur u tha se duhet të synojmë të shkojmë drejt 2%, madje për disa aleatë, ata interpretuan se ai ishte tavan për ta, pra se si mund të shkonin më lart. Shpresoj që në Vilnius do të jemi në gjendje të biem dakord për

një angazhim shumë më të fortë, që do të thotë se nuk duhet t'i referohemi 2% si diçka drejt të cilës synojmë të shkojmë, por duhet të kemi 2% jo si tavan, por si dysheme, një minimale, që të gjithë ne duhet ta dorëzojmë menjëherë, jo brenda një dekade. Dhe nëse ka ndonjë gjë, lufta në Ukrainë ka treguar për të gjithë aleatët nevojën për të investuar më shumë në mbrojtje. Kështu që unë mirëpres përparimin që kemi bërë. Unë dua të shoh edhe më shumë. Jam i sigurt se në Vilnius do të kemi një angazhim më të fortë për të investuar më shumë në mbrojtje”.

Madje Sekretari i Përgjithshëm tha se kjo duhet të bëhet menjëherë. Ai u shpreh mbi perspektivën dhjetëvjeçare se 2014 është shumë ndryshe nga 2023 dhe gjërat kanë ndryshuar shumë tashmë. “Aleatët kuptuan në gusht 2014, kur u mbajt Samiti i Uellsit, se ne jetonim në një botë më të rrezikshme, por kjo është edhe më e dukshme tani me agresionin masiv të Rusisë kundër Ukrainës”. Por Stoltenberg tha gjithashtu se lidhur me shpenzimet 2% gjithçka do të shqyrtohet. “Ky tekst do të negociohet, unë do të paraqes propozimet e mia, do të shtyj fort që aleatët të bien dakord për diçka që është më e fortë, duke iu referuar minimumit 2%, ku nuk do të kemi një dekadë të gjatë, por duhet të jetë diçka që duhet arritur sa më parë, menjëherë, pa pritur më shumë se sa është absolutisht e nevojshme”, - tha ai. Stoltenberg tha gjithashtu se kjo mund të realizohet deri në vitin 2030 por disa aleatë janë shumë larg nga 2%, theksoi ai dhe se nuk ka asnjë mënyrë për të dyfishuar shpenzimet e tyre të mbrojtjes brenda një viti. “Por aleatët e tjerë, dhe gjithnjë e më shumë aleatë, tani janë mjaft afër 2% dhe ata mund të jenë atje shumë shpejt. Mesazhi duhet të jetë se afati nuk është më një dekadë, të gjithë duhet të jeni në 2% sa më shpejt të jetë e mundur. Ky duhet të jetë mesazhi nga Vilnius!”

Koncepti i ri Strategjik i NATO-s adresoi sfidat nga Kina

Ndër të tjera, në Konceptin e ri Strategjik thuhet se: “Ne do të mbrojmë vlerat tona të përbashkëta dhe rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke përfshirë lirinë e lundrimit”. Po çfarë do të thotë kjo në praktikë dhe a mund ta imagjinohet një angazhim i NATO-s në mbajtjen e Detit të Kinës Jugore ose Ngushticës së Tajvanit të hapur për transportin ndërkombëtar, ishte çështja tjetër që shtroi Rasmussen.

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg tha se aleatët e NATO-s janë të pranishëm gjithashtu edhe në Detin e Kinës Jugore. Ata lundrojnë atje me anije tregtare dhe me anije ushtarake ose detare. “NATO do të mbetet një aleancë rajonale në Amerikën e Veriut dhe në Evropë. Por ajo që u deklarua qartë për herë të parë në Konceptin Strategjik për të cilin ramë dakord në Madrid vitin e kaluar ishte se Kina ka rëndësi për sigurinë tonë dhe Kina përbën një sfidë për interesat tona, vlerat tona dhe për sigurinë tonë”. Kjo është gjithashtu një nga arsyet pse NATO po punon edhe më ngushtë me partnerët e Azi-Paqësorit, si dhe NATO ka theksuar qartë se status quo-ja në dhe rreth Tajvanit nuk duhet të ndryshohet me forcë. Retorika kërcënuese e Kinës dhe sjellja kundër Tajvanit është e pajustificuar dhe çdo mosmarrëveshje rreth Tajvanit duhet të zgjidhet me mjete paqësore.

INTERVISTË ME ISH-PËRGJEGJËSIN E MUZEUT TË FA-SË, DR. ASLLAN ZEMANI

Asllan Zemani: Kujtesa historike është palca e një kombi

INTERVISTOI:
ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Dr. Asllan Zemani, u lind në qytetin e Tiranës. Pas përfundimit të gjimnazit “Qemal Stafa”, vijoi studimet e larta në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve dhe në vitin 1981 u titullua ‘oficer’.

Më pas emërohet në detyrën e shefit të stërvitjes në brigadën sulmuese në qytetin e Librazhdit, e më pas shef i stërvitjes në repartin ushtarak të qytetit të Lezhës. Pas rreth tetë vjetësh në këto detyra, ndoqi studimet në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë, pas të cilës emërohet komandant batalioni në njësitë e Tiranës. Boton shkrime nga aspekte të jetës dhe të veprimtarisë së repartit por edhe për historinë ushtarake dhe përvojën luftarake të popullit tonë në shekuj.

Me ndryshimet që po ndodhnin në ushtri dhe reformën që po bëhej hap pas hapi, në vitin 1993, për rezultate të dukshme emërohet punonjës shkencor dhe pedagog në Akademinë e Mbrojtjes, në departamentin e Historisë Ushtarake. Ishte kjo një mundësi e mirë për të thelluar më tej njohuritë dhe për të filluar një punë kërkimore shkencore, ku vetë institucioni i Akademisë e kishte përparësi. Krahas punës si pedagog në lëndën e historisë ushtarake, filloi dhe përgatitjet për provimin universitar për lëndën “Historia e shek. XX”, në Fakultetin e Historisë në Universitetin e Tiranës, studime në Arkivin e Shtetit dhe në Arkivin e Forcave të Armatosura.

Në vitin 2000, paraqiti temën e disertacionit “Organizimi i formacioneve ushtarake të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare” dhe mori gradën shkencore “Doktor i shkencave në fushën ushtarake”. Në të gjithë këtë rrugëtim, mbi 40 vjet në shërbim në FA-së, ka botuar mjaft shkrime, kumtesa, studime dhe libra të publikuar. Është bashkautor në librat e publikuar si “Personalitete ushtarake shqiptare në vite” (1912-1997), vëllimi 1, “Historia e Ushtrisë Shqiptare”, (Organizimi), 1912-1944, vëllimi I, “Albanian Armed Forces in Photos”, “the History, Graziani Arti Gra-fiche-Corato” Bari, Itali dhe “Agresion ushtarak, gusht ‘49”. Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 2008, është autor i disa zërave të mesëm dhe zërave të vegjël të botuar.

Dr. Asllan Zemani prej vitesh përgjegjës i Muzeut të Forcave të Armatosura, njohës dhe studiues historik i aseteve të këtij institucioni, sot në pension, por gjithmonë me pasionin dhe dashurinë për këtë vlerë të ushtrisë shqiptare, vjen

për gazetën ‘Ushtria’ në Ditën Botërore të Muzeve, me një pasqyrim të plotë të aktivitetit dhe vizionit për të ardhmen e këtij institucioni të rëndësishëm të historikut të Forcave të Armatosura.

Z. Asllan, pse është caktuar 18 maji ‘Dita Ndërkombëtare e Muzeve’?

Data 18 maj është Dita Ndërkombëtare e Muzeve në mbarë botën. Në vitin 1977, me Rezolutën Nr.12 të Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (ICOM) është caktuar 18 Maji, si “Dita Ndërkombëtare e Muzeve”. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve, që varet nga UNESCO, ka ndihmuar në ngritjen e nivelit shkencor të muzeve përmes botimeve të ndryshme, veçanërisht në përcaktimin e kriterëve dhe standardeve për trajtimin e objekteve të trashëgimisë kulturore. Më shumë se 30 000 muze në rreth 100 vende të botës, përfshirë edhe vendin tonë, angazhohen me aktivitete të larmishme me rastin e kësaj dite. Edhe për Muzeun e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Dita Ndërkombëtare e Muzeve ka qenë një ditë e shënuar me një aktivitet origjinal gjithëpërfshirës. Në këtë kuadër është përgatitur dhe realizuar “Dita e Hapur”, çdo vit, me objektivin e qartë për të promovuar vlerat historike të Forcave të Armatosura jo vetëm tek ushtarakët, por në mbarë shoqërinë e interesuar për këtë qëllim nëpërmjet objekteve muzeore të shumtë dhe të cilët përbëjnë Historinë e Ushtrisë Shqiptare.

Kur filloi aktivitetin e tij, Muzeu i Forcave të Armatosura ?

Në kufijtë e mbylljes së një shekulli jete të pandërprerë juridikisht si shtet dhe si Forca të Armatosura më së fundi, në korpusin e ndërtesave muzeale për nga vlerat, të KDS-së (tani të M. Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së) u krijua institucioni i Muzeut të FA-së, ku në zanafillën e tij gradualisht po kristalizohet arkivimi i historisë së këtij shekulli jete për Forcat e Armatosura, ashtu siç është kjo periudhë ekzistence, me të mirat e me problemet e saj, me lavdinë dhe me dështimet. Historia e varësisë të këtij institucioni për herë të parë nga Ministria e Mbrojtjes (atëherë Ministria e Mbrojtjes Popullore) e ka zanafillën e vet menjëherë pas dekadës së parë pas çlirimit të vendit, tashmë siç dihet e emërtuar “Muzeu i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”. Më pas, në vitet ‘60, kemi rritje në numër të muzeve nëpërmjet dy tipologjive të tyre, në muzetë historikë të Armës (shërbimit), i Aviacionit, i Tankeve, i shërbimit të ndërlidhjes, dhe muzetë historikë të Njërive, të cilat kryesisht hapat e para të tyre i kishin si ekspozita të thjeshta me të dhëna historiko - dokumentare nga jeta dhe veprimtaria e njërive përkatëse dhe më pas në vitet ‘70 ato morën karakterin e muzeut, duke u përsosur vazhdimisht. Ndhimesë spikatëse për këto ka dhënë



muzeologu Major Riza Drishti. Fatkeqësisht i gjithë ky rrjet i dendur i muzeve, ku konservohej dhe ekspozohej vetë identiteti, historia dhe veprimtaria e një pjese të historisë së Forcave të Armatosura, u harruan deri në dëmtim e vjedhje qysh në fillimet e viteve ‘90, duke lënë Ushtrinë Shqiptare pa një “shtëpi” ku të ruhej dhe të ekspozohej historia dhe tradita e saj në fushën ushtarake, fushë ku nga shumë studiues pranohet dhe shumë fakte historike vërtetojnë se, gjendet një pjesë shumë e rëndësishme dhe përfaqësuese edhe e historisë së kombit shqiptar.

Kujtesa historike është palca e një kombi, sepse pa të nuk mund të projektosh asgjë për të ardhmen. Po nuk dite se nga vjen si do të dish ku do të shkosh? Kjo sentencë shumë domethënëse për ndërtimin e një Muzeu ndoshta Kombëtar Ushtarak, ishte ngacmim ngulmues qysh në fund të viteve ‘90 nga historianët ushtarakë, duke u kurorëzuar me ngritjen e një komisioni nismëtar me në krye ushtarakun, studiuesin dhe pedagogun e vjetër të Historisë Ushtarake dhe të Forcave të Armatosura, koloneli, prof. dr. Proletar Hasani.

Në kujdesin e veçantë të z. Pandeli Majko (atëherë Ministër i Mbrojtjes) kjo nismë u kurorëzua me miratimin e një drafti, të konsultuar me muzeologë me eksperiencë, mbi të cilin do të bazohej e gjithë përmbajtja e muzeut. Njëkohësisht u bë edhe përnjohja e terrenit për të përzgjedhur se ku do ndërtohej ky institucion, duke patur parasysh sipërfaqen relativisht të madhe për shtrirjen e tij. Më pas heshtje dhe me këmbënguljen e grupit nismëtar, më 3 nëntor 2008, u zhvillua edhe një konferencë për ndërtimin e Muzeut Historik Kombëtar me ushtarakë të lartë të FA-së si dhe një personel i specializuar, që kishte përgatitur edhe referatet e punën e paraqitur për ndërtimin e këtij muzeu, i cili më së fundi filloi funksionimin në prag të festimit të 100-vjetorit të Pavarësisë dhe 100-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Shqiptare, më 4 dhjetor 2012.

Cilat janë vlerat institucionale dhe edukative që ofron ky muze?

Tashmë në këtë fillim shekulli muzetë në tërësi, këto institucione kulturore-studimore dhe edukuese, po konsiderohen e përcaktohen në dritën e një vizioni të ri, kthimin e tyre në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore. Për këtë edhe stafi i institucionit për përgatitjen e këtij projekti për perspektivën e zhvillimit të Muzeut të Forcave të Armatosura u mbështet në këto politika, të cilat janë:

- Respekto të shkuarën për të ndërtuar të ardhmen;
- Vizioni i ri - kthimi i muzeve në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore;
- Muzeologjia-shkencë për edukimin e brezit të ri me trashëgiminë kulturore;
- Muze për të gjithë, muze pa barriera - prioritet i muzeologjisë në mbarë botën.

Postulati, respekto të shkuarën për të ndërtuar të ardhmen, me një

përhapje të gjerë në botën e qytetëruar ka nisur të ngacmojë edhe ndjeshmërinë e shoqërisë shqiptare gjatë viteve të fundit. Komunikimi kulturor tashmë konsiderohet si një proces social i rëndësishëm me ndikim të dukshëm në zhvillimin e vendit. Në një shoqëri të hapur me komunikim dhe teknologji të zhvilluar, institucionet e kulturës luajnë një rol parësor, jo vetëm si instrumente zhvillimi, por edhe si referenca të rëndësishme historike që na orientojnë në formimin e identitetit kombëtar.

Pikërisht komunikimi nëpërmjet muzeve dhe krijimi i lidhjeve mes muzeologjisë dhe shoqërisë konsiderohet sot më shumë se domosdoshmëri. Nëpërmjet koleksioneve që prezantojnë, muzetë evokojnë vlera të mbijetesës së qytetërimeve në shekuj, duke i transmetuar ato te brezat e rinj si një trashëgimi e pazëvendësueshme. Për këtë, tashmë kemi një vizion të ri, i cili kthen muzetë në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore.

Vizioni modern nuk i koncepton muzetë vetëm si destinacione të vizitueshme, por i përcakton si qendra potencialisht edukative. Kjo nënkupton që vizitorët jo vetëm të informohen, por edhe të përfshihen në programe kreative e kërkimore. Pavarësisht nga misioni i tyre specifik si muze ushtarakë, ato janë edhe qendra komunikimi dhe perceptimi të diversitetit kulturor për vizitorët.

Muzetë janë institucione ku njerëzit shkojnë jo vetëm për t’u informuar por edhe për të mësuar. Përqasja e aktiviteteve muzeale me programet e

shkollave është një parim i rëndësishëm për mirëfunksionimin e një muzeu. Muzeologjia është një shkencë e re për realitetin shqiptar, ndaj sot shtrohet si domosdoshmëri futja e koncepteve të reja për edukimin e brezit të ri me trashëgiminë kulturore, ku muzetë dhe sitet arkeologjike zënë vendin kryesor.

‘Muze për të gjithë’, ky është edhe një prioritet i veçantë muzeologjisë në mbarë botën. Ekspozitat interesante dhe tërheqëse, interpretimi profesional i koleksioneve, respektimi i diferencave intelektuale, janë disa nga veprimtaritë që rrisin vizitueshmërinë. Shekulli 21 ka nisur me objektiva të qarta për menaxhimin e muzeve, por edhe për shumë drejtues të muzeve kombëtarë dhe lokalë në vende të ndryshme të botës, që kanë kuptuar plotësisht rëndësinë e këtyre institucioneve në zhvillimin e kulturës.

Synimi i stafit të Muzeut të FA-së ka qenë i orientuar gjithmonë në realizimin e misionit nëpërmjet vizionit modern e bashkëkohor të muzeve, duke kthyer gradualisht Muzeun e FA-së në një qendër potenciale edukative nëpërmjet prezantimit dhe propagandimit të vlerave historike të Forcave të Armatosura Shqiptare, qysh nga lindja e deri në anëtarësimin e tyre në NATO e më gjerë mbi bazën e një rikonceptimi të ri e të ndryshimit të formatit të ekspozitës në institucion muzeal, duke synuar nivelin e Muzeut Kombëtar të FA-së.

Si janë të ndarë pavijonet dhe cili është burimi i koleksioneve të këtij muzeu?

Muzeu ynë, ndonëse ka pak më shumë se një dekadë që ka filluar aktivitetin, është i pasur dhe i veçantë në llojin e tij në të gjithë rrjetin muzeor kombëtar.

Kjo ndërtesë e Muzeut të FA-së me stil ndërtimi që i përket atij të periudhës musoliniane (fashiste), është pjesë përbërëse e projektit dhe ndërtimeve të Kasermës dhe të Fushës së Xhenios, e projektuar nga Zyra e punimeve të Xhenios të Armatës pas bashkimit të shtetit dhe të Forcave të Armatosura Shqiptare me ato të Italisë fashiste. E gjithë kjo sipërfaqe arriti në afro 180.000m², në vitet 1939-1941 të shekullit të shkuar. Pikërisht në një nga këto ndërtesa, që shërbenin për depo, magazina apo ofiçina është ngritur edhe Muzeu ynë, i cili është i përbërë nga dy pjesë: nga Muzeu i Brendshëm, me hapësirat përkatëse prej rreth 1000m² si dhe Muzeu i Hapur, që ndodhet kryesisht në pjesën e pasme të kësaj ndërtese, ku janë të vendosur të gjitha kalibrat e armëve të artilerisë tokësore e kundërajrore si dhe parku i mjeteve luftarake dhe të transportit të Ushtrisë Shqiptare. Muzeu ishte ideuar dhe fatkeqësisht u zbatua si një ekspozitë armatimi fare e përkohshme për 2 deri në 3 muaj pa ndarje të domosdoshme të historisë, sipas periudhave historike që ka kaluar organizimet e Ushtrisë Shqiptare.

Ky muze përbëhet nga tre pavijone: Holli qendror, Pavijoni i Epokës 1450-1944 dhe Pavijoni i Luftës së Ftohtë.

Holli qendror i këtij Muzeut

Në këtë hapësirë, që shërben edhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme përkujtimore apo për hapje ekspozitash me tematikë të ndryshme, janë vendosur fotot e të lidershipit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së sipas periudhave kohore respektive të drejtimit të këtyre dy institucioneve kryesore të Ushtrisë Shqiptare, në krahun përballë ndodhen dy ekspozitorë me emblema apo stema të dhuruara nga personalitete apo vizitorë të ushtrive të ndryshme pjesëtarë apo jo të NATO-s si dhe të vizitorëve vendas. Në skajin tjetër ndodhet këndi me objekte muzeale që së bashku me pianon, janë përdorur në periudhën e para viteve ’90 nga ish-Shtëpia Qendrore e Ushtrisë. Objekti muzeal, që ndodhet në qendër të muzeut me elemente artistike, është një ekzemplar i Raketës Sam-2, prodhim kinez, pjesë përbërëse e Forcave të Armatosura Shqiptare në vitet 1960-1990.

Pavijoni i periudhës 1450-1944

Në këtë pavijon janë ekspozuar objekte muzeale të përdorura gjatë periudhave më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar, duke filluar me armë të përdorura në periudhën e Skënderbeut e deri tek armët trofe të Luftës së Dytë Botërore.

Pavijoni i Luftës së Ftohtë

Në këtë pavijon janë ekspozuar objekte muzeale të Ushtrisë Shqiptare të periudhës së viteve 1945 deri në 1990. Gjejnë pasqyrim që nga fishekët e kalibrit më të vogël deri tek mortajat e lehta dhe granatahdhësit. Janë ekspozuar objekte muzeale të tre forcave kryesore ushtarake, Forca Tokësore, Detare dhe Ajrore.

Gjithashtu janë pasqyruar objekte muzeale të armëve dhe shërbimeve të ndryshme në ushtri si: logjistika, transporti, xhenio, ndërlidhja, kimia dhe shëndetësia.

Përveç objekteve muzeale të periudhës së komunizmit janë ekspozuar pushkë dhe pistoleta të viteve 1900-2000.

- Me mjaft interes për vizitorët është mënyra e paraqitjes së predhave të kalibrit të rëndë, minave, granatave të dorës, të cilat qëndrojnë të vendosura në kutitë e tyre e shprehin qartazi masivitetin e depove të municioneve dhe tuneleve nëntokësorë në të gjithë Shqipërinë. Sapo futesh në këtë pavijon hasesh me ekspozimin e një numri të madh helmetash që të sjellin ndërmend paradat ushtarake të zhvilluara në vitet 1980-të.

Interesante është harta me relief Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Greqisë. Kjo hartë është përdorur në Akademinë Ushtarake për procesin mësimor, ku studentët mësonin taktikën ushtarake duke iu bazuar relievit. Avio-shenjë është përdorur gjatë stërvitjes për qitje të artilerisë kundërajrore, i cili shërbente për tërheqjen e objektivit të qitjes.

Në këtë pavijon shohim një kabinë piloti Mig-21, ky ishte avioni reaktiv më modern i Flotës sonë Ajrore.

Çadër fushore, për të sjellë në kujtesë fushimet dhe zboret e ushtrisë, është ngritur kjo çadër fushore.

Në hyrje të muzeut, në pozicionin vertikal është vendosur raketa Sam-2. Kjo raketë është prodhuar në Kinë dhe është përdorur në FA në vitet 1960-1990.

Pavijoni i katit të dytë

Arsimimi, në disa stenda të vendosura në katin e dytë, është pasqyruar historiku i arsimimit ushtarak shqiptar. Historiku i arsimimit fillon me hapjen e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” në 1945, vazhdon me Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në 1946, Akademinë e Mbrojtjes, Akademinë e Aviacionit, Akademinë e Marinës dhe Akademinë e Nënoficerëve në 1995.

Këndi i Forcave Speciale dhe i Batalionit Komando. Në këtë kënd janë pasqyruar aspekte të forcave speciale dhe forcave komando gjatë misioneve paqeruajtëse në vende të ndryshme. Këto dy forca janë të ilustruara me foto dhe uniformat përkatëse.

Jeta artistike. Këndi i objekteve muzeale të jetës artistike kulturore në Forcat e Armatosura në vitet 1950-1990. Kryesisht këto objekte janë kostume popullore, aparate fotografikë dhe filmimi.

Këndi i sportit. Sporti dhe përgatitja fizike kishin një rëndësi të madhe në FA. Pas çlirimit të vendit, brenda FA-së u formua klubi shumë-sportesh “Partizani”.

Toporelievi i vendit tonë. Në pavijonin e katit të dytë është vendosur një toporeliev gjigand, i ndërtuar i gjithi me dorë nga Instituti Gjeografik i Ushtrisë. Për ndërtimin e kësaj harte janë dashur 10 vjet punë. Kjo hartë e shkallës 1:50.000 përfshin Shqipërinë, Kosovën, një pjesë të madhe të Maqedonisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Ky toporeliev, paraqet të gjitha format e relievit, qendrat e banuara, rrjetin hidrografik, rrjetin rrugor dhe hekurudhor.

Pavijoni i Jashtëm

Në pavijonin e ambientit të jashtëm të muzeut janë vendosur armë të rënda të artilerisë, mjete të transportit, tanke, avionë reaktivë Mig-19 dhe Mig-21, helikopterë, 4 silurus si dhe një bunker i vogël. Pjesa më e madhe e këtyre objekteve janë prodhime kineze.

A realizohet mirëmbajtja e tyre dhe cilat janë teknikat, kur bëhet fjalë për koleksione të një rëndësie të veçantë?

Meqenëse fondi bazë i objekteve muzeore i armëve apo pajisjeve i përkasin periudhës historike të viteve 1945-1990, mendoj se ato do të jenë hëpërhë baza e këtij muzeu, të cilat janë vendosur sipas periudhave të organizimit të Ushtrisë Shqiptare, të ndarë me pavijone apo mini-pavijone në vartësi të sasisë së tyre. Të gjitha objektet muzeore të periudhës së përcaktuar që do të vendosen në hapësirat e brendshme të muzeut të vendosen të grupuara, objektet muzeore

të armatimit konvencional së bashku edhe me pajisjet e shërbimeve si prapavija, ndërlidhja, kimia, xhenio etj.

Në tërësinë e tyre, ky arsenal i objekteve muzeore, mirëmbahen dhe pastrohen nga stafi i këtij institucioni. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Rep. Usht. 4009, bëhet herë pas here rinovimi i pjesëve të ndryshme të këtij armatimi apo dhe lyerja e mirëmbajtja kryhet sipas një grafiku të hartuar me këtë njësi.

Cilat periudha të Historisë Ushtarake Shqiptare datojnë këto koleksione të muzeut?

Siç përmenda më parë, fondi bazë i objekteve muzeore, i armëve apo pajisjeve të tjera, i përkasin periudhës historike të Ushtrisë Shqiptare të viteve 1945-1990, të cilat sipas fazave të organizimeve të saj janë vendosur sipas kësaj kronologjie:



a. Ushtria Kombëtare Shqiptare, 1945-1954; (Faza e parë) ku kemi krijimin e aviacionit ushtarak (24 prill 1951); më 1953 shërbimin kimik, radio-zbulimin etj.; njëherësh u ringrit Marina Luftarake, tanket, artileria, transporti, prapavijat e të tjera; arsimimi ushtarak.

b. Ushtria Popullore Shqiptare, 1955-1965; (Faza e dytë) hyrja në Traktatin e Varshavës, 14 maj 1955 dhe dalja, shtator 1968. Ushtria Shqiptare u fuqizua me teknikë luftarake si topa obuzë, tanke, autoblanda, artileri vetëlëvizëse (AVL), katër-silurues, mjete speciale drejtimi, ndërlidhje, xheniere, prapavije etj. nga ish-Bashkimi Sovjetik.

c. Ushtria Popullore Shqiptare, 1966-1975; shtimi me pajisje e armatime e teknika të reja luftarake kineze;

d. Ushtria Popullore Shqiptare në vitet ’70-’80; hartohet për herë të parë plani operativo-strategjik, tekstual dhe grafik, për mbrojtjen e vendit;

e. Ushtria Popullore Shqiptare në vitet 1982-1990; futen shumë armë dhe teknikë e rëndë, si tanke dhe artileri të prodhimit kinez, të cilat e rritën dukshëm fuqinë e saj edhe në rajon.

Paraqitja e këtyre objekteve me vlera historike, shkencore dhe kulturore, në radhë të parë janë të siguruara, të mbrojtura nga dëmtimet, vjedhjet, lagështira, thatësira, drita e diellit dhe pluhuri, si dhe njëkohësisht deri diku kanë një ndriçim optimal që ato duken mirë. Të gjitha objektet, janë të ndara nga ato për studim tek ato objekte për ekspozim. Njëkohësisht është bërë një selektim i kujdesshëm i materialeve, apo vendosje e tyre e rregullt në hapësirë, nëpër ambiente me formë të përshtatshme por edhe me një rrjedhë logjike sa më interesante. Vendosja e tyre është bërë duke zbatuar rregullin, që këndi i të parit normal fillon 27° nga niveli i syve dhe gjerësia dhe lartësia e ambienteve i përgjigjet kësaj norme. Ndërsa varja e stendave të veçanta nëpër mure është rreth 3 - 5 m2, ndërsa ato që i përkasin një epoke të tërë, në mungesë të objekteve muzeore siç është periudha e Skënderbeut, shkojnë 6 – 10 m2/copë. Ndërsa vendosja e mjeteve të rënda janë bërë mbi bazamente betoni të ndërtuara në përputhje me peshat, tipin e rrotave etj.

Për ambientet e muzeut, cilësia e ndriçimit është vendimtare. Meqenëse në këtë ndërtesë nuk është parashikuar sa e si duhet ndriçimi artificial, më shumë dominon ndriçimin natyral me dritare të vendosura në të dy faqet e ndërtesës. Mendoj dhe shpresoj se këto

rregulla mjaft strikte do të zbatohen në Muzeun e ri, në Bërzhitë.

Cilat janë pavijonet që kanë problem në konceptim dhe duhet të rishikohen?

Tërësia e pavijoneve të muzeut kanë nevojë për rikonceptim apo për ndriçim, por edhe një sërë rregullash strikte që të marrë formën e plotë të një muzeu. Por, sipërfaqja e vogël në raport me numrin e madh të objekteve muzeore por edhe mungesave të tjera të mirëmbajtjes së objektit e kushtëzojnë shumë zgjidhjen e këtyre problemeve. Por në muzeun e ri shpresoj që të plotësohen dhe të jetë një muze bashkëkohor.

Sa i frekuentuar është Muzeu i FA-së nga turistët vendas apo të huaj qofshin ata?

Qasja ndaj komunitetit dhe shoqërisë sonë, është një tjetër fokus, i cili ka për qëllim të specifikojë vlerat të cilat i mbartim prej shekujsh, të artit dhe të kulturës, në raport me vlerat shoqërore, por jo në vlera ekonomike. Një nga prioritetet strategjike, i cili vazhdon dhe mbetet edhe tani është “Njohja, përhapja dhe promovimi i vlerave të trashëguara të Ushtrisë Shqiptare si dhe ato kulturore, artistike, në shërbim të brezave të rinj, shoqërisë sonë, nëpërmjet grumbullimit, konservimit dhe të ekspozimit të vlerave më të çmuara dhe autentike, që lidhen drejtpërdrejt me historinë, trashëgiminë dhe identitetin e Forcave të Armatosura. Muzeu si institucion ka nënshkruar disa marrëveshje, me universitete publike dhe private, për një bashkëpunim ku shkëmbimi, organizimi, promovimi, kërkimi dhe studimi, planifikimi apo projektimi i shumë aktiviteteve, seminareve, trajnimeve, të përbashkëta etj. Muzeu, me koleksionet e tij, ekspozitat, aktivitetet e ndryshme, cilëson veten si një institucion dinamik, i cili rriti dhe vlerësoi jetën kulturore të komunitetit tonë. Ndërkohë, promovimi në rrjetet sociale, në formatet video ose foto, është gjithashtu një domosdoshmëri dhe një sprovë për të qenë në qendër të vëmendjes. Krahas promovimit dixhital, në MFA mund të aplikohen dhe forma të tjera dhe të reja teknologjike.

A kemi një numër të përafërt të vizitorëve në një ditë në Muze dhe në cilat periudha interesi është më i lartë?

Si rezultat i intensifikimit të masave të përmendura më sipër, në periudhën para pandemisë u rrit së tepërmi numri i vizitorëve vendas por edhe të atyre të huaj, të cilët me anë të e-mail-eve rezervonin datat e vizitave të tyre.

Me gjithë përpjekjet tona por edhe të drejtorisë nga kishim varësinë nuk mundëm që të thjeshtonim rregullat e hyrjes dhe daljes të vizitorëve vendas dhe të huaj. Në rastin më të mirë vizitorët e ndryshëm, vendas e të huaj, që tregonin interes të madh për Muzeun e FA-së, arrinin rreth 6000 deri 7000 vizitorë në muaj. Madje ka pasur raste që një pjesë e këtyre vizitorëve kanë zhvilluar dhe orë mësimi për njohjen e Historisë Ushtarake apo të Forcave të Armatosura Shqiptare si Shkolla “Çajupi”, “Sami Frashri” por edhe shkollat private të këtyre niveleve. Njëkohësisht është bashkëpunuar edhe me Fakultetin e Historisë, dhe pothuaj 3-4 vitet e fundit, 3-4 studentë bëjnë praktikën 1-2 mujore tek muzeu.

Grupmosha më e shpeshtë e vizitorëve dhe çfarë pëlqejnë më shumë?

Interes të madh për këtë muze në tërësi tregonin të gjitha grupmoshat, por sidomos nxënësit e arsimimit parauniversitar shfaqnin interes të veçantë, madje e shoqëronin edhe me pyetje specifike që tregonte se ata kishin lexuar para se të bënin vizitën në këtë muze.

Nëse flasim për turistët e huaj, cilat nacionalitete janë më të interesuara për të njohur vlerat historike të Ushtrisë Shqiptare përmes objekteve?

Interesim dhe vizita të shumta kishim grupe vizitorësh perëndimorë, si anglezë, francezë, italianë, amerikanë, danezë, suedezë, finlandezë, gjermanë etj. Interesimi i tyre ishte kryesisht tek tipologjia e armatimeve konvencionale apo edhe për llojet e kalibrave të ndryshëm të artilerisë tokësore e kundërajrore. Kishte shumë syresh që kishin njohuri për të dhënat tekniko-taktike të armatimeve të ndryshme, të cilat në muze janë objekte muzeore.

Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballlet ky institucion?

Tashmë në këtë fillim të dekadës së tretë të shekullit të 21-të, muzetë në tërësi, këto institucione kulturore-studimore dhe edukuese, po konsiderohen e përcaktohen në dritën e një vizioni të ri, kthimin e tyre në platforma komunikimi të standardeve bashkëkohore. Për këtë, edhe stafi i institucionit vijojnë ecurinë e implementimit të këtij projekti, për perspektivën e zhvillimit të Muzeut të Forcave të Armatosura në bashkëpunim edhe me Muzeun Historik Kombëtar por edhe me institucione të rrjetit muzeor po bënë përpjekjet e duhura për zbatimin e tij.

Audio-guida është projekti i parë, është domosdoshmëri për vizitorët për t’u njohur më mirë me përmbajtjen e muzeut me anë të audio-guidave në gjuhë angleze dhe atë shqip, siç janë pajisur edhe muzetë më të mirë europianë. Kjo paraqet vështirësi të shumta sepse tipologjia e Muzeut të FA-së është e veçantë, si nga madhësia e hapësirës, kronologjia historike, numri i lartë i objekteve dhe gjithashtu larmia e pavijoneve, gjithmonë flas për implementimin e tij në muzeun e ri të Bërzhitës. Në këtë aplikacion mund të krijohen edhe disa kategori, ku e para është audio-guida, e dyta është galeria e fotive, lajmërimet mbi aktivitetet e muzeut etj. Të vendosur në disa tabletë 10 inch, të pajisur me kufje, ku çdo vizitor mund ta marrë atë dhe ta përdorë guidën individuale në audio në dy gjuhë.

Një sugjerim tjetër që mund të bëja është edhe marrëdhënia e muzeut me donatorët, duhet ngritur e forcuar dhe më pas të zgjerohet nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme bashkëpunuese.

Akti i AI-së: Një hap më afër rregullave të para mbi Inteligjencën Artificiale

Për të siguruar një zhvillim të inteligjencës artificiale (AI) me në qendër njeriun dhe etikën në Evropë, eurodeputetët miratuan rregullat e reja të transparencës dhe menaxhimit të rrezikut për sistemet e AI-së.

Të enjten, Komiteti i Tregut të Brendshëm dhe Komiteti i Lirive Civile miratuan një projekt-mandat negociues për rregullat e para për Inteligjencën Artificiale me 84 vota pro, 7 kundër dhe 12 abstenime. Në amendamentet e tyre në propozimin e Komisionit, eurodeputetët synojnë të sigurojnë që sistemet e AI-së të mbikëqyren nga njerëzit, të jenë të sigurta, transparente, të gjurmueshme, jo-diskriminuese dhe miqësore me mjedisin. Ata gjithashtu duan të kenë një përkufizim të njëtrajtshëm për AI të projektuar për të qenë neutral ndaj teknologjisë, në mënyrë që të mund të zbatohet për sistemet e AI-së të sotme dhe të nesërme.

Qasje e bazuar në rrezik për AI-në - Praktikë e ndaluar të AI-së

Rregullat ndjekin një qasje të bazuar në rrezik dhe vendosin detyrime për ofruesit dhe përdoruesit në varësi të nivelit të rrezikut që mund të gjenerojë AI-ja. Sistemet e inteligjencës artificiale me një nivel të papranueshëm rreziku për sigurinë e njerëzve do të ndalohen rreptësisht, duke përfshirë sistemet që përdorin teknika të nënkuptuara ose manipuluese të qëllimshme, shfrytëzojnë dobësitë e njerëzve ose përdoren për vlerësime sociale (klasifikimi i njerëzve në bazë të sjelljes së tyre sociale, statusit socio-ekonomik, personal karakteristikat).

Deputetët e PE-së ndryshuan në mënyrë thelbësore listën për të përfshirë ndalimet për përdorimet ndërhyrëse dhe diskriminuese të sistemeve të AI-së si:

- Sistemet e identifikimit biometrik në distancë “në kohë reale” në hapësira të aksesueshme nga publiku;

- Sistemet e identifikimit biometrik “post” në distancë, me përjashtim të vetëm të zbatimit të ligjit për ndjekjen e krimeve të rënda dhe vetëm pas autorizimit gjyqësor;

- Sistemet e kategorizimit biometrik që përdorin karakteristika të ndjeshme (p.sh. gjinia, raca, përkatësia etnike, statusi i shtetësisë, feja, orientimi politik);

- Sistemet parashikuese të policisë (bazuar në profilizimin, vendndodhjen ose sjelljen kriminale të kaluar);

Sistemet e njohjes së emocioneve në zbatimin e ligjit, menaxhimin e kufijve, vendin e punës dhe institucionet arsimore; dhe,

- Gërvima pa kriter e të dhënave biometrike nga mediat sociale ose pamjet e CCTV për të krijuar baza të dhënash për njohjen e fytyrës (shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtës për privatësi).

AI me rrezik të lartë

Eurodeputetët zgjeruan klasifikimin e zonave me rrezik të lartë për të përfshirë dëmtimin e shëndetit, sigurisë, të drejtave themelore ose mjedisit të njerëzve. Ata gjithashtu shtuan sistemet e AI-së për të ndikuar tek votuesit në fushatat politike dhe në sistemet rekomanduese të përdorura nga platformat e mediave sociale (me më shumë se 45 milionë përdorues sipas Aktit të Shërbimeve Dixhitale) në listën me rrezik të lartë.

AI për qëllime të përgjithshme, masat e transparencës

Eurodeputetët përfshinin detyrime për ofruesit e modeleve të themelimit - një zhvillim i ri dhe me zhvillim të shpejtë në fushën e AI-së, të cilët do të duhet të garantojnë mbrojtje të fuqishme të të drejtave themelore, shëndetit dhe sigurisë dhe mjedisit, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Ata do të duhet të vlerësojnë dhe të zbusin rreziqet, të jenë në përputhje me kërkesat e projektimit, informacionit dhe mjedisit dhe të regjistrohen në bazën e të dhënave të BE-së.



Modelet e themelimit gjenerues, si GPT, do të duhet të përputhen me kërkesat shtesë të transparencës, si zbulimi se përmbajtja është krijuar nga AI, dizajnimi

i modelit për të parandaluar gjenerimin e përmbajtjes së paligjshme dhe publikimin e përmbledhjeve të të dhënave me të drejtë autori të përdorura për trajnim.

Mbështetja e inovacionit dhe mbrojtja e të drejtave të qytetarëve

Për të rritur inovacionin e AI-së, eurodeputetët shtuan përjashtime në këto rregulla për aktivitetet kërkimore dhe komponentët e AI-së të ofruara nën licencat me burim të hapur. Ligji i ri promovon ‘sandboxet’ rregullatore, ose mjediset e kontrolluara, të krijuara nga autoritetet publike për të testuar AI-në përpara vendosjes së saj.

Eurodeputetët duan të rrisin të drejtën e qytetarëve për të paraqitur ankesa për sistemet e AI-së dhe për të marrë shpjegime të vendimeve të bazuara në sistemet e AI-së me rrezik të lartë që ndikojnë ndjeshëm të drejtat e tyre. Eurodeputetët gjithashtu reformuan rolin e Zyrës së BE-së për AI-në, e cila do të kishte për detyrë të monitoronte se si zbatohet rregullorja e AI-ja.

Pas votimit, bashkë-raportuesi Brando Benifei (S&D, Itali) tha: “Ne jemi në prag të vendosjes së legjislacionit historik që duhet t’i rezistojë sfidës së kohës. Është thelbësore të ndërtohet besimi i qytetarëve në zhvillimin e AI-së, për të vendosur rrugën evropiane për përballimin e ndryshimeve të jashtëzakonshme që tashmë po ndodhin, si dhe për të drejtuar debatin

politik mbi AI-në në nivel global. Ne jemi të bindur se teksti ynë balancon mbrojtjen e të drejtave themelore me nevojën për të ofruar siguri ligjore për bizneset dhe për të stimuluar inovacionin në Evropë”.

Bashkë-raportuesi Dragos Tudorache (Rinew, Rumani) tha: “Duke pasur parasysh ndikimin e thellë transformues që do të ketë AI-ja në shoqëritë dhe ekonomitë tona, Akti i AI-së është me shumë mundësi pjesa më e rëndësishme e legjislacionit në këtë mandat. Është pjesa e parë e legjislacionit të këtij lloji në mbarë botën, që do të thotë se BE-ja mund të udhëheqë rrugën për ta bërë AI-në të përqendruar te njeriu, të besueshëm dhe të sigurt. Ne kemi punuar për të mbështetur inovacionin e AI-së në Evropë dhe për t’u dhënë sipërmarrjeve fillestare, SME-ve dhe industrisë hapësirë për t’u rritur dhe inovuar, duke mbrojtur të drejtat themelore, duke forcuar mbikëqyrjen demokratike dhe duke siguruar një sistem të pjekur të qeverisjes dhe zbatimit të AI-së.”

Përpara se të fillojnë negociatat me Këshillin për formën përfundimtare të ligjit, ky projekt-mandat negociator duhet të miratohet nga i gjithë Parlamenti, ndërsa votimi pritet në seancën e 12-15 qershorit.

Lufta kundër dhunës ndaj grave: Eurodeputetët mbështesin pranimin e BE-së në Konventën e Stambollit

Eurodeputetët kanë votuar për të miratuar aderimin e Bashkimit Evropian në Konventën për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, duke përfunduar rolin e Parlamentit në këtë proces.



Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, i datës 6 tetor 2021, konfirmoi se Bashkimi Evropian mund të ratifikojë Konventën e Stambollit pa pasur marrëveshjen e të gjitha shteteve anëtare.

Gjykata konstatoi se fusha e duhur për anëtarësimin në BE është azili, bashkëpunimi gjyqësor në çështjet penale dhe detyrimet e institucioneve të BE-së dhe administratës publike. Në përputhje me këtë, eurodeputetët votuan për të dhënë pëlqimin e tyre në dy vota të veçanta: për institucionet dhe administratën publike të Unionit me 472 pro, 62 kundër dhe 73 abstenime; për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, azilin dhe moskthimin me 464 pro, 81 kundër dhe 45 abstenime.

Anëtarësimi i BE-së në Konventën e Stambollit nuk i përjashton vendet anëtare që ta ratifikojnë atë vetë, kanë thënë vazhdimisht eurodeputetët, duke u bërë thirrje gjashtë vendeve të mbetura - Bullgaria, Çekia, Hungaria, Letonia, Lituania dhe Sllovakia - të ratifikojnë Konventën pa vonesë, në mënyrë që ajo mund të mbrojë gratë në masën e plotë të qëllimit të synuar të Konventës.

Lukasz Kohut (S&D, Poloni) eurodeputeti kryesor për Komitetin për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet

e Brendshme, tha: “Dhuna me bazë gjinore është problemi më i madh i pazgjidhur i përditshëm në Evropë. Një në tre gra në BE ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale - rreth 62 milionë gra. Ka ardhur koha t’i japim fund. Konventa e Stambollit njihet si mjeti më efektiv për të luftuar dhunën me bazë gjinore, pasi ajo imponon detyrime konkrete. Një ombrellë e ligjit evropian kundër dhunës do të mbrojë gratë dhe vajzat në Evropë, përmes aderimit të BE-së

në Konventën e Stambollit.

Arba Kokalari (EPP, Suedi) kryedeputetja e PE-së për Komitetin për të Drejtat e Grave dhe Barazinë Gjinore, tha: “Është koha që BE-ja të ratifikojë Konventën e Stambollit. BE-ja duhet të rritet dhe të kalojë nga fjalët në veprim për të ndaluar dhunën me bazë gjinore, për të mbrojtur viktimat dhe për të ndëshkuar autorët. Më vjen shumë mirë që BE-ja më në fund po ndërmerr hapat e nevojshëm për sigurinë dhe liritë themelore të grave në Evropë. Pas gati

dhjetë vitesh shtytje nga Parlamenti Evropian, tani ratifikimi i Konventës së Stambollit do të rrisë standardet në luftimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

Këshilli tani mund të vazhdojë me përfundimin e pranimin të BE-së në Konventë.

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave (‘Konventa e Stambollit’) është teksti i parë ndërkombëtar që përcakton ligjërisht dhunën ndaj grave dhe vendos një kornizë gjithëpërfshirëse të masave ligjore dhe politike për parandalimin e një dhune të tillë, mbështetjen e viktimave dhe ndëshkimin e autorëve.

Në tetor 2015, Komisioni miratoi një udhërrëfyes, i cili arriti në përfundimin se anëtarësimi i BE-së në Konventë do të krijonte një kornizë koherente të nivelit të BE-së për të luftuar dhunën ndaj grave, do të përmirësonte parandalimin për të gjitha gratë dhe do të ofronte mbrojtje dhe mbështetje më të mirë për gratë dhe fëmijët që janë viktimat të dhunës dhe grupeve të veçanta të grave.

AI tashmë po nxjerr jashtë loje një profesion të rëndësishëm dhe punëtorët janë të shqetësuar

Inteligjenca Artificiale po dominon titull pas titulli tani, dhe nuk është e vështirë të kuptosh pse. Në Hollywood, shkrimtarët e WGA po shkojnë në grevë pjesërisht sepse shqetësohen se si AI do të ndikojë në karrierën e tyre dhe shumë punëtorë në fusha të tjera janë të shqetësuar se si kjo teknologji në zhvillim mund të ndikojë në punët e tyre. Tani, AI-ja tashmë ka arritur të kryejë një punë të madhe: sipas ‘Digital Journal’, botuesit po përqafojnë librat audio të AI-së dhe po i largojnë gjithnjë e më shumë transmetuesit njerëz nga tabloja.

Në retrospektivë, rritja e librave audio të AI është diçka që ne vërtet duhet ta kishim parë të vinte. Aktualisht, AI-ja përpiket të krijojë gjëra nga e para, siç janë romanet, pa redaktim të gjerë njerëzor. Për shumë shkrimtarë dhe punëtorë në fusha të tjera, kjo çon në një pyetje disi filozofike: nëse këtyre kompanive do t’u duhet ende të punësojnë redaktorë për ta bërë të këndshëm tekstin e krijuar nga AI, pse të mos e përjashtoni thjesht ndërmjetësin dixhital dhe të vazhdojë të mbështetet tek njerëzit për të krijuar histori shumëgjyreshe dhe bindëse nga e para?

Fatkeqësisht për transmetuesit, librat audio të AI-së janë diçka krejtësisht e ndryshme. Teksti tashmë është shkruar, kështu që teknologjia nuk ka pse të dalë me një histori origjinale verbuese. Në vend të kësaj, e gjithë teknologjia që duhet të bëjë është të imitojë lartësinë, kadencën dhe shpërndarjen e përgjithshme të linjës së një transmetuesi njerëzor, dhe kjo është mjaft e lehtë për t’u bërë, saqë botues të panumërt tani po mbështeten në të.



Dhe këta audio-libra të AI-së tashmë kanë një efekt të dukshëm në industri për transmetuesit njerëzorë. Tregimtarëve veteranë si Tanya Eby u është shkurtuar përgjysmimi i ngarkesës aktuale të punës dhe gjërat ka të ngjarë të përkeqësohet përpara (ose nëse) të përmirësohen. Sa për Eby-n, ajo ka vënë në dukje rreziqet e kësaj teknologjie që transformon peizazhet e njohura mediatike.

Për shembull, ndërsa është kënaqësi për një person mesatar të ulet diku dhe të ketë diçka si ChatGPT të krijojë një lojë teksti në ‘Star Trek’ për të luajtur, një numër në rritje i kompanive po gjejnë mënyra për ta përdorur këtë teknologji për të krijuar

zbrazëtira ligjore që kërcënojnë të dëmtojnë punëtorët, duke përfshirë transmetuesit profesionistë. Për shembull, Eby thekson se ndërsa do të ishte e paligjshme të kopjohet

të librave të Harry Potter sesa Jim Dale ose Stephen Fry. Megjithatë, kushton rreth një e katërta e çmimit për t’u mbështetur tek transmetuesit e AI-së dhe jo tek njerëzit, kështu që botuesit do të mbështeten gjithnjë e më shumë tek ata, pavarësisht asaj që ne e konsiderojmë një rënie të dukshme të cilësisë.

Ka disa kompani që qëndrojnë pas librave audio të AI-së, duke përfshirë ‘DeepZen’, që bëjnë gjithçka për të paguar aktorët për përdorimin e zërit të tyre dhe madje u ofrojnë atyre honorare për librat audio të shitur. Fatkeqësisht, kjo qasje më etike ndaj AI-së duket të jetë përjashtim dhe jo normë.

Mënyra e zgjuar e ChatGPT-së për të balancuar 9 vezë me objekte të tjera bindi disa studiues të Microsoft-it se AI po bëhet gjithnjë e më shumë si njerëzit

Disa studiues të Microsoft AI ishin të bindur se ChatGPT po bëhej gjithnjë e më shumë si njerëzit për shkak të

përgjigjes së tij të zgjuar ndaj një detyre balancuese, raportoi ‘The New York Times’.

Në një studim prej 155 faqesh, shkencëtarët kompjuterikë të Microsoft hulumtuan ndryshimet midis GPT-3 dhe GPT-4. Versioni i fundit fuqizon chatbot-in e Bing dhe modelin “Plus” të ChatGPT-së, i cili kushton 20 dollarë në muaj.

Punimi, i titulluar “Shkëndija e Inteligjencës së Përgjithshme Artificiale”, shqyrtoi një sërë sfidash, duke përfshirë matematikën e komplikuar, kodimin kompjuterik dhe dialogun e stilit të Shekspir. Por ishte një ushtrim bazë arsyetimi që e bëri teknologjinë më të fundit OpenAI të dukej kaq mbresëlënëse.

“Këtu kemi një libër, nëntë vezë, një laptop, një shishe dhe një gozhdë”, - thanë studiuesit për chatbot. “Ju lutem më tregoni se si t’i vendos ato mbi njëri-tjetrin në një mënyrë të qëndrueshme”.

GPT-3 u ngatërrua pak këtu, duke sugjeruar se studiuesit mund

të balanconin vezët në majë të një gozhide, dhe më pas laptopin në majë të tij.

“Ky përgjigje mund të mos jetë shumë i qëndrueshëm, kështu që është e rëndësishme të jeni të kujdesshëm kur e trajtoni atë”, - tha bot.

Por pasardhësi i tij i përmirësuar kishte një përgjigje që në fakt i habiti studiuesit, sipas ‘NY Times’.

Ai sugjeroi se ata mund t’i rregullonin vezët në një rrjet tre-ngatre në krye të librit, në mënyrë që laptopi dhe pjesa tjetër e objekteve të mund të balanconin në të.

“Laptopi do të përshtatet mirë brenda kufijve të librit dhe vezëve, dhe sipërfaqja e tij e sheshtë dhe e ngurtë do të sigurojë një platformë të qëndrueshme për shtresën tjetër”, - tha roboti.

Fakti që GPT-4 mund të zgjidhte një enigmë që kërkonte një kuptim të botës fizike, tregoi se ishte një hap drejt inteligjencës së përgjithshme artificiale - zakonisht shihen si makina që janë po aq të afta sa njerëzit.

“Të gjitha gjërat që mendova se nuk do të ishte në gjendje t’i bënte, sigurisht që ishte në gjendje të bënte shumë prej tyre, nëse jo shumicën e tyre”, - tha Sébastien Bubeck, autori kryesor i gazetës, për ‘NY Times’.

Përparimet e shpejta në teknologji kanë nxitur të pëlqejnë investitorin e shquar të AI-së, Ian Hogarth të paralajmërojnë se AGI ishte ‘si Zoti’ dhe mund të shkatërronte njerëzimin duke na bërë të vjetëruar.

Ka ende një të ardhme të pasigurt përpara, por studimi tha se GPT-4 tregoi vetëm ‘shkëndijat’ e AGI.

“Pretendimi ynë se GPT-4 përfaqëson përparimin drejt AGI-së nuk do të thotë se është i përsosur në atë që bën, - shkruajnë studiuesit, - ose që i afrohet aftësisë për të bërë gjithçka që një njeri mund të bëjë”.



Krijimi i bazës së Kuçovës, aset i Forcave të Armatosura në rrugën e shndërrimit të saj në bazë të NATO-s

Reparti Ushtarak 3362 Kuçovë mbante emrin Reparti “23 Peza”. Ai u krijua si formacion i parë i madh luftarak i Forcave Ajrore për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Bërthama e parë e këtij regjimenti u krijua me vendim të posaçëm, ku u morën masa për përgatitjen e efektivit pilot e teknik për teknikën e re reaktive me të cilën do të pajisej reparti. Krahas këtyre u morën masa për përgatitjen e ambienteve për pritjen e efektivit dhe teknikës.

Pas përfundimit të përgatitjes së efektivit pilot e inxhinieroteknik, Regjimenti mori formën e plotë, i gatshëm për kryerjen e detyrave.

15 maj 1955 është dita e krijimit të regjimentit

Me vendim të posaçëm të Kuvendit Popullor Nr.81 datë 06.11.1956, Regjimentit i dorëzohet Flamuri Luftarak me mbishkrimin “Regjimentit 23 të Aviacionit Gjuajtës PEZA”

Në janar të vitit 1956, në regjiment filloi përgatitja luftarake e organizuar mbi bazën e një planëzimi të rregullt. Në maj të këtij viti me urdhër të ministrit të Mbrojtjes u krijua nënreparti i oficinës së mirëmbajtjes së aviacionit me komandant Daut Gurabardhi, ndërkohë që një pjesë e pilotëve shkuan për studime për helikopterë.

Në korrik të vitit 1957, në këtë aerodrom u ul për herë të parë avioni bombardues JI-28, i cili hyri në armatimin e Aviacionit tonë Luftarak. Në dhjetor në Kuçovë ulet një avion transporti anglez “Skymaster”. Me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor për kryerjen me sukses të kësaj detyre u dekoruan pilotët Kosta Dede e Mahmut Hysa, si dhe aviodrejtesi Shyqyri Balla.

Në muajin shtator 1959, regjimenti mori pjesë në stërvitjen me trupat e armatës në rajonin e Ersekës. Dhe në muajin nëntor regjimenti mori pjesë në paradën ushtarake me rastin e 15-vjetorit



qitje natën me raketa, ndërsa në vitin 1977 për herë të parë eksperimentohet bombardimi nga fluturimi horizontal në lartësi të vogël.

Në vitin 1979, në detyrën e komandantit të regjimentit emërohet Harilla Rebi dhe në atë të komisarit, Viktor Vangjeli. Po këtë vit u vu në gatishmëri për drejtimin luftarak të regjimentit Vendkomanda e Kohës së Luftës.

Në paradën ajrore me rastin e 35-vjetorit të çlirimit të Atdheut, reparti mori pjesë me 9 avionë.

Në mars të vitit 1981, me ndihmën e efektivit pilot e teknik të repartit, Kinostudio “Shqipëria e re” xhiroi filmin artistik “Gjurmë në kaltërsi”, kushtuar armës së Aviacionit, ku ndihmë konkrete dhanë pilotët Harilla Rebi, Viktor Vangjeli, Agim Balili, Gjergji Spaho, etj., duke kryer një sasi të madhe fluturimesh në funksion të filmit, si dhe duke organizuar e ndihmuar edhe në punët e tjera.

Në vitin 1984, reparti emërohet “Regjimenti 23 i Aviacionit Gjuajtës Bombardues”, ndërsa në vitin 1985 dekorohet me urdhrin “Për shërbime të shquara në fushën e mbrojtjes”.

Në vitin 1995 krijohet Baza e Mbrojtjes Ajrore Kuçovë, Reparti Ushtarak 4030 (ish-1875).

Viti 1999, është viti i kthimit në normalitet, ndërsa në vitin 2001, me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, në strukturën e re organizative të Forcave Ajrore, ky repart kalon në “Akademia e Forcave Ajrore”, duke pasur në vartësi dhe Fakultetin Teoriko-Mësimor Vlorë.

Në vitin 2003 vazhduan punimet nga pala turke në aerodromin e Kuçovës, të cilat përfunduan në kohë sipas planit.

Në vitet në vazhdim si detyrë kryesore ka qenë modernizimi i infrastrukturës për plotësimin e standardeve dhe kushteve të aerodromit të Kuçovës si “Host Nation Support”

Disa prej drejtuesve në vite të Bazës së Kuçovës ishin: Niko Hoxha, Fahri Bubësi, Bardhyl Taçi, Harilla Rebi, Agim Balili, kolonel Fatmir Meçe, nënkolonel Agim Matraku, Gëzim Ismaili, Andon Todri, Tomorr Dyrmo, Flamur Hoxha, Syrja Gjoka.

Tashmë, NATO po investon për modernizimit të bazës ajrore të

Kuçovës. Ky investim strategjik i NATO-s në Shqipëri do të sjellë një standard të ri për Forcat e Armatosura dhe do të shërbejë si bazë mbështetëse për NATO-n, duke ofruar transport ajror, mbështetje logjistike, policimin ajror si dhe trajnime dhe stërvitje.

Kuçova do të shërbejë njëkohësisht edhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore Shqiptare dhe ky Investim strategjik i NATO-s në Shqipëri, do të sjellë një standard të ri për Forcat tona të Armatosura. Padyshim, një investim i këtyre përmasave krijon mundësi të reja për zhvillimin ekonomik e social të të gjithë rajonit, ku planifikohet ndërtimi i kësaj baze të re ajrore të teknologjisë së fundit.



të çlirimit të atdheut.

Në muajin prill të vitit 1961, për herë të parë filloi eksperimentimi i karburantit të markës shqiptare, i prodhuar nga punonjësit e laboratorit të naftës, me në krye inxhinierin Stefan Kagjini. Komandanti i Regjimentit, piloti Niko Hoxha me avionin 332 bëri provën e parë në ajër.

Në vitin 1964, në vartësi të regjimentit u krijuan dy reparte të reja, Batalioni i Shërbimit të Aerodromit dhe Grupi i Radio-Dritës.

Në vitin 1965 krijohet skuadrilja e tretë reaktivo-mësimore për përgatitjen e pilotëve, teknikëve të rinj, me komandant pilotin Sali Dibra.

Në fillim të vitit 1966 filluan punimet për ndërtimin e Uzinës së Riparimit të Avionëve, ndërsa në muajin prill reparti pajiset me një skuadrilje “MIG-17”.

Në gusht të vitit 1975 eksperimentohet për herë të parë

Shkodra, qyteti që 'vallëzon mbi dy rrota'

Shkodra qyteti që 'vallëzon mbi dy rrota', qyteti ku 'parkimi' i biçikletave ishte elementi kryesor në evidentimin e vlerave oksidentale të kohës. Prandaj, nëse flasim për historinë e biçikletave të para në vendin tonë, kjo histori duhet të nisë nga qyteti në veriperëndim, që shtrihet në ultësirë, e ndoshta, kjo shtrirje gjeografike ka ndikuar edhe më shumë që biçikleta pasi hyri për herë të parë, të gjejë shtëpinë e saj në Shkodër.

Kur u shfaq biçikleta e parë dhe kush i kish hipur asaj gjëje me dy rrota?

Ishte viti 1907, më shumë se një shekull, kur në Shkodër u pa të lëvizte rrugëve të saj, me kalldrëm e me pluhur, një i huaj. Ai përdorte një mjet që askush që nuk kishte dalë jashtë vendit, ta kishte parë më parë.

Ky burrë ishte konsulli i nderit i Suedisë, ndaj edhe kureshtja për ta parë ishte mjaft e madhe. Dëshmitë e kohës rrëfejnë se kush e dëgjoi, u dynd andej nga rruga kryesore ku ai lëvizte që ta shihte me sy atë mjet që ecte mbi dy rrota pa u tërhequr nga kafshët.

Me kaq, kurioziteti u shua, po s'u shua lakmia për ta pasur. Kush ishte më i pasur dhe që kishte mundësi të dilte jashtë shtetit, e solli një të tillë. Biçikletat që nisën të hynin në Shkodër ishin të markave të ndryshme, më së shumti italiane. Por në kuadrin historik duhet të përmendim edhe një foto të dy burrave me biçikleta, të nxjerrë nga fototeka "Marubi" e vitit 1897, me veshje kombëtare shqiptare, por që nuk janë të evidentuar se kush janë.

Kronikat e kohës dëshmojnë se fillimisht biçikleta në Shkodër u quajt "Velisipet", por edhe dyrrrotullake.

Por Shkodra shënon edhe një rekord tjetër që lidhet me biçikletën.

Gruaja e parë që nisi një biçikletë vinte nga konsullata austriake.

Njerëzit sërisht u dyndën nëpër rrugë për ta parë atë dhe kuptuan se dyrrrotaku nuk ishte pronësi vetëm e meshkujve, por se edhe femrat mund ta nisin një të tillë.

Kështu biçikleta fitoi qytetarinë e saj. Është fakt interesant se në vitin 1915, policia e qytetit u pajis me biçikleta dhe ushtronte detyrën e saj duke përshkruar rrugët me biçikleta.

Me shtimin e numrit të biçikletave, një grup qytetarësh shkodranë, në vitin 1920 vendosën të krijonin sportin e çiklizmit. Rrethi i parë çiklistik, që është edhe i treti në Europë për nga vjetërsia, pas Francës e Italisë, është organizuar pikërisht në Shkodër.

Ndaj dhe në vazhdimësi Shkodra ia ka dhënë tonin këtij sporti, aq sa jo vetëm të rriturit, por nuk ka fëmijë që të mos dijë të ngasë biçikletën.

Duke pasur parasysh se shtëpitë shkodrane ishin një dhe



dykatëshe dhe se shumica prej tyre kishin oborre për t'i mbajtur, duke pasur parasysh edhe faktin se Shkodra është një qytet që pozicionohet në ultësirë dhe të jep mundësi pedalimi të mirë, nga viti në vit numri i biçikletave erdhi duke u shtuar.

Pas çlirimit të vendit, zhvillimi i Shkodrës, krijimi i një zone industriale jashtë vijës së verdhë të qytetit, e bëri biçikletën një mjet pune të domosdoshëm, jo vetëm për burrat, por edhe për vajzat e për gratë.

Biçikleta që zgjidhja e vetme për të përshkruar në mungesë të makinës, 12 km gjatësi dhe 6 km gjerësi qytet, për të shkuar në punë, për të bërë shëtitje buzë liqenit, për të shkuar në periferi, për të dalë në Pjacë, apo për të takuar miq. Kërkesa për biçikleta po rritej dhe nuk po përballohej dot.

Çdo shtëpi kishte dy ose tre të tilla. Kërkesat në rritje shtuan importin e tyre, fillimisht nga vendet e Lindjes e më pas nga Kina. Me biçikleta dilnin në punë mjekët e mësuesit, mjeshtrit e çirakët, inxhinierët e artistët, nëpunësit e ushtarakët, etj.

Nga fundi i viteve '50 të shekullit të kaluar, kur Shkodra kishte rreth 60 000 banorë, ka të dhëna të plota se në qytet numëroheshin mbi 10 000 biçikleta.

Ishte koha kur edhe biçikletat regjistroheshin dhe çdo qytetar, ndaj një pagese simbolike merrte një llamarinë me fushë të bardhë sa një celular mesatar, ku kishte të stampuar numrin, që ishte i detyruar ta vendoste nën shalën e biçikletës.

Shkodra ka disa rekorde sa i takon biçikletës, p.sh. biçikleta e parë dyshe hyri në Shkodër, sikundër pati edhe numrin më të madh të dyqaneve të shërbimit për riparimin e tyre.

Pas ndryshimeve të vitit 1991, me mbylljen e shumë ndërmarrjeve dhe hyrjen e makinave private, duket sikur ra edhe numri i madh i përdorimit të biçikletave. E nëse deri dje qyteti ecte plotësisht mbi dy rrota, sot ai ndoshta në të njëjtat raporte ecën mbi katër rrota, mbi makina të markave të ndryshme, megjithatë askush nuk ka mundur t'ia heqë nga koka kurorën e kampionës së biçikletave. Pasi përditë me mijëra të tilla qarkullojnë rrugëve të qytetit. Nuk është rastësi që në një studim europian të vitit 2011, Shkodra përmendet si qytet rekord në Shqipëri, madje në Europën Juglindore dhe atë Qendrore, me një përqindjeje të lartë pedalimi prej 29%.

Ajo renditet mes qyteteve europiane të njohura për kulturën e lartë pedaluese, të tilla si: Bolzano, Ferrara, Fraiburg, qytetet e Vendeve të Ulëta dhe Vendeve Skandinave.

Sot qyteti me traditën më të hershme në Shqipëri në përdorimin e biçikletave, i ka kushtuar një ditë të veçantë festive këtij mjeti, që vazhdon të përdoret edhe sot e kësaj dite nga rreth 30 për qind e banorëve, ç' ka e rendit atë në qytetin e pestë në Europë për përdorimin e biçikletave, gjithnjë në raport me numrin e banorëve.

Si pjesë e traditës, vazhdimisht në këtë qytet organizohen shëtitje kolektive me biçikleta në vendet piktoreske të qytetit dhe në zonat rreth tij.

Bashkia Shkodër është përfshirë në mënyrë aktive në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj kulture dhe tradite, duke dhënë ndihmesën e saj.



Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, 17 maj 1914 - 8 qershor 1915

Kryengritja e Shqipërisë së Mesme, 17 maj 1914, klasifikohet te ‘Kryengritjet’ pasi pati mbështetje popullore tek fshatarët e Shqipërisë së Mesme, ku edhe shpërtheu. Kjo kryengritje nisi, më 17 maj 1914, kundër regjimit të Princ Vedit. Udhëheqësit zyrtarë të rebelimit ishin Haxhi Qamil Fejza dhe Musa Qazimi, por prapa saj qëndronte Esat Pashë Toptani. Kryengritja u nda në 2 faza:

Faza 1: Kryengritësit u drejtuan nga ish-ushtarakë të Perandorisë Osmane, të cilët i dinin të gjitha mënyrat për të mposhtur forcat e Princ Vedit.

Faza 2: Kryengritësit sulmojnë pronat e Esat Pashë Toptanit, pasi ai ishte mbështetës i Antantës pra kundërshtar i Turqisë.

Gjendja politike ishte e vështirë për vendin

Grekët të maskuar si “vorio-epirotë” mbanin të pushtuar jugun e vendit, kurse Esat Pashë Toptani komplotonte vazhdimisht kundër qeverisë dhe Princ Vedit.

Fuqitë e Mëdha ndërkohë e kishin harruar Shqipërinë pasi po bëheshin gati të përplaseshin me njëra-tjetrën. Gjithashtu ishte rritur veprimtaria e agjunkturës turke kundër qeverisë kombëtare të Shqipërisë.

Zona e Lëvizjes:

Tirana, Kruja, Durrësi, Lushnja, Kavaja, Peqini, Elbasani, Librazhdi, Fieri, Berati, Kuçova, Pogradeci, Gramshi, Ballshi dhe Vlora.

Maj 1914

Kryengritësit të udhëhequr nga Haxhi Qamili dhe Musa Qazimi me thirrjet “Dum Babën” shpartallojnë, tek Ura e Limuthit në afërsi të Tiranës, një grup vullnetarësh tiranas dhe kosovarë, të cilët po shkonin në Shqipërinë e Jugut, për të luftuar kundër forcave vorio-epirote që kishin pushtuar Shqipërinë e Jugut.

18 maj 1914

Grumbuj fshatarësh të egërsuar marrin Shijakun dhe drejtohen drejt kryeqytetit, Durrësit.

Kryengritësit dalin haptazi kundër Princ Vedit dhe regjimit të tij pro-perëndimor.

19 maj 1914

Princ Vidi dha urdhër të arrestohej Esat Pashë Toptani me akuzën e përfshirjes në organizimin e kryengritjes. Esat Pasha reziston dhe me ndërhyrjen italiane largohet nga vendi.

28 maj 1914

Princ Vidi i jep urdhër Turhan Pashë Përmetit të formojë kabinetin e ri qeveritar. Ndërkohë kryengritësit, duke mos marrë dot Durrësin, nisen drejt qyteteve të tjera. Durrësi qëndron nën një rrethim të ashpër.

Faza e dytë

Më 2 tetor u kthye në Shqipëri Esat Pashë Toptani. Më parë, kishte firmosur një marrëveshje me kryeministrin serb Nikolla Pashiq me të cilën i premtonte Serbisë aneksimin e Shqipërisë Veriore dhe Lindore, si shpërblim Serbia e ndihmoi me mercenarë dhe me të holla. Në Durrës Esat Pasha shpalli veten kryetar të Qeverisë së Shqipërisë së Mesme. Me anë të grupimeve pro-osmane të kryengritjes e zgjeroi pushtetin në Shqipërinë e Mesme. Ai u premtoi kryengritësve se do t’i shpronësonte bejlerët. Pas hyrjes së Perandorisë Osmane në luftë në anën e fuqive të Boshtit, marrëdhëniet e Esat Pashës me rebelët u përkeqësuan.

Esati, i cili ishte i lidhur me fuqitë e Antantës, ndërmori veprime kundër rebelëve pro-turq, kurse këta filluan ta luftonin Esat Pashën si tradhtar të otomanizmit dhe pronar të madh tokash.

Në nëntor 1914 rebelët dogjën shtëpinë e Esat Pashës në Laprakë dhe hynë në Tiranë, ku Haxhi Qamili dogji shtëpitë e bejlerëve dhe agallarëve patriotë.

Esat Pasha, i cili kishte mbetur i rrethuar në Durrës, mobilizoi me ndihmën e fuqive të huaja rreth 6000 mercenarë për të sulmuar Tiranën, por me të marrë vesh këtë Haxhi Qamili



mobilizoi rreth 2000 fshatarë luftëtarë dhe sulmoi ushtrinë e Esatit në fshatin Zezë afër Krujës duke e shpartalluar. Esati u kthye prapë në Durrës.

Në fillim të vitit 1915, Stambolli, i cili tashmë kishte pranuar që Shqipëria të mbetej nën ndikimin e aleatit të saj austro-hungarez, u dërgoi rebelëve udhëzime që të orientonin politikën e tyre drejt Austro-Hungarisë dhe jo drejt bashkimit me Turqinë. Kjo kthesë shkaktoi përçarje në mesin e udhëheqësve të rebelimit. Njëri krah për shkak të orientimit të ri hoqi dorë nga parullat për bashkim me Turqinë, kurse krahu i pro-turqve fanatikë, ku bënë pjesë Haxhi Qamili dhe Man Picari, vazhduan t’i konsideronin parullat pro-turke si programin kryesor të kryengritjes.

Më 9 maj 1915, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të rebelëve, u zgjodh kryetar Musa Qazimi, kurse më 13 maj Haxhi Qamili u zgjodh Komandant i Përgjithshëm. Pas kësaj Qamili nuk pyeste më askënd për veprimet e tij. Persekutonte patriotët dhe u digje shtëpitë, prandaj filluan ta quanin Haxhi Zjarrmi. Ai shante poshtëronte, arrestonte, burgoste dhe vrste pa gjyq kundërshtarët.]



ME NËNSHKRIMIN E TRAKTATIT TË FSHEHTË TË LONDRËS, NË PRILL 1915, MBYLLEJ SHTEGU PËR DALJEN E SERBISË NË ADRIATIK PËRMES SHQIPËRISË SË MESME. SERBIA, DUKE NDJERË QË PO I CENOHESHIN INTERESAT, VENDOSI TË SHTINTE NË DORË KËTË RAJON E PARA DHE TË DILTE NË DURRËS. NË KËTË MËNYRË AJO FORCONTE EDHE POZITAT E LËKUNDURA TË VASALIT TË SAJ ESAT PASHË TOPTANIT ME TË CILIN KISHTE MARRËVESHJE TË FAVORSHME.

Shtypja e kryengritjes

Me nënshkrimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës, në prill 1915, mbyllej shtegu për daljen e Serbisë në Adriatik përmes Shqipërisë së Mesme. Serbia, duke ndjerë që po i cenoheshin interesat, vendosi të shtinte në dorë këtë rajon e para dhe të dilte në Durrës. Në këtë mënyrë ajo forconte edhe pozitën e lëkundura të vasalit të saj Esat Pashë Toptanit me të cilin kishte marrëveshje të favorshme. Ushtria serbe e gjendur përballë presionit austro-hungarez, mbasi nuk kishte rrugë tjetër, hartoi plane për t’u tërhequr përmes Shqipërisë dhe për të mbërritur në skelat e Detit Adriatik, nga ku do të largohej me anijet e Aleatëve. Esat Pasha deklaroi se nuk do t’i luftonte forcat serbe gjatë tërheqjes.

Duke parandjerë rrezikun, në fund të majit rebelët pro-turq i dërguan komandantit të ushtrisë serbe në Ohër dy nota me anën e të cilave pohonin qëndrimin asnjansës, kërkonin që të ruheshin marrëdhëniet miqësore dhe premtonin se Serbisë nuk do t’i shkactohej asnjë dëm nga kryengritësit. Por kërkesat e tyre nuk u përfillën. Më 2 qershor 1915 ushtria serbe sulmoi Shqipërinë nga tre drejtime, në Shqipërinë e Mesme u ndeshën me kryengritësit, të cilët i thyen dhe arritën deri në afërsi të Durrësit, duke çliruar nga rrethimi disamujor Esat pashë Toptanin. U arrestuan kryetarët e kryengritjes Haxhi Qamili dhe Musa Qazimi, duke i nxjerrë përballë gjyqtarit Xhelal Bej Zogu, i cili urdhëroi ekzekutimin e tyre. Dhe kështu mori fund Kryengritja në Shqipërinë e Mesme, e cila e çoi Shqipërinë drejt shkatërrimit.

Mizoritë

Gjatë rebelimit “forcat disiplinore” të rebelëve të cilat drejtoheshin nga myftiu i Tiranës, Musa Qazimi, kryen ekzekutime me qëllim të “spastrimit” të “Skizmatikëve bektashinj”. Përveç “Skizmatikëve bektashinj” viktimat të tjera të rebelëve ishin të krishterët, mësuesit patriotë shqiptarë, të cilët përdornin alfabetin latin dhe klerikët myslimanë të cilët mbështesnin kombin shqiptar.

Në listën e të arrestuarve dhe të burgosurve në Berat, në periudhën janar-shkurt 1915, ishin vetëm bejlerët që përkrahnin pavarësinë e Shqipërisë. Edhe në Elbasan ishin burgosur e internuar bejlerët e tillë, krahas atdhetarëve me prejardhje të ndryshme shoqërore. Për udhëheqësin e rebelimit, Haxhi Qamilin, bejlerët që donin pavarësinë e Shqipërisë ishin “spiunë të kaurëve”, ata që donin Turqinë ishin të mirë.

Në fazën e dytë të kryengritjes (tetor 1914-qershor 1915), krerët e rebelimit vranë atdhetarët e njohur, si Ismail Klosi, Hajredin Fratari, Baki Gjebrea, Hysen Gjirokastra etj.

Ligjet dhe traditat që frenojnë gruan, frenojnë të gjithë shoqërinë

Në Luftën e Dytë Botërore, pas pushtimit fashist, më 7 prill 1939, gratë që në fillim të LANÇ-it morën pjesë masivisht në përkrahje të kësaj lufte.

Ato jo vetëm u angazhuan totalisht në LANÇ, gatuanin, mjekonin të plagosurit dhe të sëmurët, fshihnin partizanët, por ishin edhe në ballë të luftës, duke marrë pjesë me armë në dorë në luftë kundër fashistëve e nazistëve e tradhtarëve të vendit, Balli Kombëtar e zogistëve.

Gratë morën pjesë në të gjitha demonstratat që u zhvilluan kundër okupatorëve fashisto-nazistë. Në demonstratën që zhvilluan gratë e Tiranës më 17 shtator 1942, para burgut fashist italian në Tiranë, ra heroikisht në përlëshje me xhandarët e burgut Heroina e Popullit Mine Peza.

Lufta e grave kishte një organizimin e drejtim të duhur. Pas krijimit të BGSH në të gjithë territorin u ngritën Organizata e BGSH, të cilat mobilizuan dhe sqaruan gratë, pse duhet të bashkoheshin në Frontin e Luftës Antifashiste. Numri i grave që u bënë shembull për luftën e tyre të papërkulur kundër fashistëve e nazistëve erdhi duke u rritur vazhdimisht. Gratë dhe vajzat në drejtimin e Organizatës antifashiste të gruas, dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm në Luftën për liri. Ato luftuan përkrah vëllezërve të tyre partizanë dhe treguan heroizëm, trimëri, guxim e emancipim.

Në memorien e kombit janë të pavdekshme, qëndresa heroike e vajzave luftëtare, flamurtare të lirisë, pesë heroina të varura në litar nga nazifashistët dhe veglat e tyre kolaboracionistë: Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Fato Berberi, Ganimet Tërbeshi dhe Sofie Noti, që s'u tutën edhe përpara torturave më të rënda e trekëndëshit nazist.

Në korrik të vitit 1943 Organizata e BGASH do të nxirrte organin e saj "Gruaja shqiptare". Ky organ pasqyronte luftën e grave gjatë LANÇ-it.

Gratë u bënë pjesë e brigadave të UNÇSH-së. Në to u radhitën mbi 6000 luftëtare. Në LANÇ, ranë dëshmore 250 gra dhe këto 25 heroina të popullit, si Margarita Tutulani, Shejnazë Juka, Qeriba Derri, Liri Gero, Inajete Dumi, Ylbere Bilibashi etj. Organizata Bashkimi i Grave Antifashiste të Shqipërisë luajti rolin e vet në të gjithë Shqipërinë. Kudo u ngritën organizata të grave antifashiste të cilat luajtën

rol të madh në LANÇ deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë. Në tetor 1944 në Berat u mbajt Kongresi i Parë i BGSH-së, që i dha edhe më shumë vull angazhimit e pjesëmarrjes së grave në LANÇ në betejën përfundimtare për çlirimin e vendit.

Pushteti popullor e gjeti Shqipërinë të varfër dhe të shtypur. Në kohën e sundimit të mbretit Zog, 90% e popullsisë ishin analfabetë. Në vitin 1946 u hapën kurse në tërë vendin, ku u regjistruan mbi 13 000 gra e vajza. Në vitin 1947 mësuan shkrim e këndim 26 185 gra e vajza. Në vitin 1948 kjo shifër arriti në 27 183 dhe në vitin 1950 arriti në 72 000 gra e vajza. U hapën shkollat e para pas luftës, ku mësuesi hero Ndrec Ndue Gjoka hapi në Mirditë 50 shkolla. Reaksioni dhe bandat kriminele e vranë "Mësuesin e përhapjes së Dritës së diturisë". Në vitin 1961 plaga e analfabetizmit të gratë dhe vajzat nën moshën 45 vjeç u mbyll.

Arsimi 7-8 vjeçar u bë i detyrueshëm, pa pagesë. Në vitin 1970-1980 ishin

krijuar kushte që 70% e të rinjve e të rejave mund të ndiqnin sipas dëshirës arsimin e mesëm. Në vitin 1975-1980 vajzat përbënin 50% të studentëve. Në këto vite u hapën shkolla profesionale, u ngritën institucionet kulturore, artistike, universiteti, akademi që përpara nuk ekzistonin.

madhe për emancipimin e gruas iu dha pjesëmarrjes së gruas në punë, duke krijuar bazën e pavarësisë ekonomike të saj. Në vitin 1950 gratë e vajzat përbënin 20% të forcave të punës, kurse në vitin 1960 ato përbënin 42% të forcave të punës.

Më 2 dhjetor 1945 për herë të

mbi 10 000 gra e vajza të zgjedhura në organet e pushtetit dhe 40 gra deputete.


Ndryshimet politike, ekonomike dhe kulturore në Shqipërinë e pasluftës, ndikuan në rikonfigurimin e problemit gjinor dhe situatën mbi pabarazinë gjinore, e cila ka qenë dhe mbetet ndër problemet e mprehta të shoqërisë shqiptare. Problemi gjinor në Shqipëri u ndie me intensitet të lartë në vitet '30-të të shekullit të kaluar. Ndjeshmëria ndaj problemit gjinor dhe pabarazisë gjinore, u pasqyruan në mendimin shoqëror shqiptar të kohës, sidomos në mendimin dhe krijimtarinë letrare. Megjithatë, për shkak të kushteve historike, politike, ekonomike e shoqërore, emancipimi real i grave dhe vajzave, në kontekstin e viteve '30-të, ishte i vështirë dhe pothuajse i pamundur. Gjatë gjithë historisë moderne të vendit, në shoqërinë shqiptare janë konstatuar ndërveprime dhe ndërvlerësi të dukshme midis problemit gjinor dhe problemit fetar. Trajektorja e ndikimit të institucioneve, besimeve dhe ideve fetare në shoqërinë shqiptare prodhoi midis të tjerave trajektoren e problemit gjinor, të pabarazisë gjinore dhe qëndrimit të spikatur të shoqërisë ndaj fesë.

Gratë shqiptare gjatë periudhës së Mbretërisë Shqiptare, kanë qenë



Këto përgatitën kadro të arsimuar për të gjitha degët e ekonomisë dhe të arsimit e kulturës. Një rëndësi e

parë gruaja mori pjesë në votim, ku zgjodhi deputetët për në Asamblenë Kushtetuese. Në vitin 1967 do të ishin



mjaft të marginalizuara. Prej kësaj pozite, ato nuk përfituan prej fillimit të proceseve të përhapjes dhe forcimit të arsimit kombëtar në Shqipëri. Pozita e tyre mbështetej por edhe vështirësohej nga legjislacioni jo favorizues në interes të zgjidhjes së problemit të emancipimit femëror dhe të pranisë së pabarazisë gjinore. Pozita e gruas në pabarazi gjinore, pësoi ndryshime të rëndësishme në disa aspekte thelbësore, gjatë shndërrimeve ekonomike, politike dhe kulturore të viteve 1945 - 1967.

Këto përmirësime përfshinë gjendjen sociale të grave, nxitjen e arsimimit, shkollimit dhe nivelit kulturor të tyre, rritjen e hapësirave për pjesëmarrje në tregun e punës dhe jetën ekonomike, rritjen e mbështetjes për pjesëmarrje në jetën politike, shoqërore e komunitare etj.



DITË E HAPUR NË TIRANË “DEFENDER EUROPE ‘23”

TË HËNËN, DATË 22 MAJ, ORA 10:00
SHESHI “NËNË TEREZA”

“Defender Europe 23”, në zemër të Tiranës! Forcat ushtarake amerikane dhe shqiptare krah për krah në sheshin “Nënë Tereza”. Çdo qytetar është i ftuar të shohë nga afër armatime dhe aspekte të ndryshme të ushtrive shqiptare dhe amerikane, pjesë e Aleancës së madhe të NATO-s. Shihemi të hënën, datë 22 maj, në orën 10:00, në këtë ngjarje që nuk duhet ta humbasësh!

